



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 19 nëntor 2019
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. *(Komision për dhënie mendimi)*
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. *(Komision për dhënie mendimi)*
4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Nikolin Staka dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Damian Gjicknuri, Elda Hoti, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Evis Fico – këshilltare e ministres

Irena Malolli – përfaqësuese nga Ministria e Infrastrukturës

Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës

Gentian Sala – Kryetari i AMA-s

Sara Xhumbari –përfaqësuese e AMA-s

Jetmir Braha – Drejtor i AKEP-it

Marsida Drushku – përfaqësuese e Drejtorisë Juridike në AKEP

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Ju urojmë një ditë dhe javë të mbarë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Sot në rendin e ditës kemi tri çështje: së pari, miratimin e procesverbalit të datës 19 nëntor të vitit 2019.

A jeni dakord me procesverbalin?

Miratohet.

Pika e dytë dhe pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjeve, që tashmë njihen si paketa antishpije “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Për të dy këto projektligje Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi dhe relatore të këtyre dy projektligjeve kemi koleget Klotilda Bushka dhe Vasilika Hysi.

Është bërë një prezantim në parim i këtyre dy projektligjeve nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, ka pasur edhe një seri seancash dëgjimore me grupet e interesit, por edhe me ekspertë ndërkombëtarë, të cilët i kemi pasur prezent në Komisionin e Ligjeve.

Të nderuar kolegë, do të fillojmë me diskutimin dhe miratimin në parim të të dy projektligjeve, shqyrtimin, miratimin nën për nen i tyre dhe më pas raporti i Komisionit të Ligjeve do t’i përcillet Komisionit përgjegjës të Medieve e më pas seancës plenare.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi prezent zotin Besmir Beja, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit, dhe zonjën Evis Fico, këshilltare e ministres; nga Ministria e Infrastrukturës kemi prezent zotin Enea Karakaçi, drejtor, nga AMA kemi zotin Gentjan Sala, drejtor i AMA-s, dhe zonjën Sara Xhumbari; nga AKEP-i është zoti Jetimir Braha, drejtor, dhe zonja Marsida Drushku, përfaqësuese nga Drejtoria Juridike.

Nëse ka përfaqësues të tjerë që nuk ua kam përmendur emrat, kur të marrin fjalën të bëjnë prezantimin!

Pasi t'i shqyrtojmë këto çështje në parim dhe Në tërësi, kemi edhe një pikë tjetër të rëndësishme të rendit të ditës që është shqyrtimi i projektvendimit për propozim Kuvendit të Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Pra, Këshilli i Ministrave ka kërkuar nga Kuvendi zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Fillimisht do ta marrë fjalën relatorja, kolegja Vasilika Hysi për të bërë një përmbledhje të të dy projektligjeve në parim dhe pastaj do të kalojmë në diskutime dhe në votim. Ndërsa në shqyrtimin nën për nën të të dy projektligjeve do të jetë relatorja Klotilda Bushka që do të ndjekë në dinamikë çdo nën që do të diskutojmë për të dy këto projektligje.

Zonja Hysi, ju lutem, shkurtimisht për kolegët deputetë dhe opinionin publik një prezantim të shkurtër të të dy projektligjeve në parim dhe i gjetjet pas zhvillimit të seancave dëgjimore dhe marrjes së opinionit të ekspertëve me shkrim!

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi- Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Sikurse e tha edhe kryetari i komisionit, komisioni ynë është për dhënie mendimi për të dy projektligjet.

Komisioni ka zhvilluar 5 mbledhje gjatë të cilave ka dëgjuar prezantimin e dy nismave nga përfaqësuesit e qeverisë, por njëkohësisht ka miratuar një kalendar të posaçëm për konsultimin publik. Kalendari, besoj e mbani mend të gjithë, përmbante një grup të gjerë të subjekteve, të personave të interesuar, duke filluar nga institucionet, organizatat ndërkombëtare të profilizuara në fushën e të drejtave të njeriut, organizatat e shoqërisë civile të specializuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe lirisë së medias, si edhe nga bota akademike, profesorë, akademikë, gazetarë, që janë të përfshirë në fushën e mësimdhënies, si edhe drejtues të të gjitha llojeve të medieeve, investigative, online, të shkruar, njëkohësisht edhe disa ekspertë që kanë përvojë në fushën e lirisë së medias dhe rregullimeve të medieeve audiovizive ose online.

Ajo që dua të theksoj është se të dy projektligjet shoqërohen me raportin e faktorëve të ndikimit në mjedis, pra me pasaportën e indikatorëve ku qeveria ka përcaktuar qartë objektivat që synon të përmbushë me këto projektligje, dhe me një projektligj tjetër që po shqyrtohet në

Komisionin e Ekonomisë, si edhe ndikimin e tyre tek AMA, por edhe te mjedisi në lidhje me lirinë e medias.

Unë nuk do të doja të analizoja dhe të theksoja se çfarë ndikimi do të ketë ky projektligj, pasi raporti që shoqëron projektligjin e përcakton në mënyrë të detajuar. Ajo që ne kemi parë në këtë komision është raporti midis nenit 10 të Konventës, lirisë së shprehjes dhe rregullave që mund të përcaktojnë ligjëvënësi në ligjet me karakter civil ose administrativ.

Meqenëse ka pasur shumë diskutime dhe debate lidhur me këtë nevojë të ndërhyrjes ligjore, në fakt, deri sot ne kemi një ligj për mediet audiovizive dhe shtypin e lirë, por nuk ka gjetur një rregullim për mediet online. Më lejoni të përmend një studim të Institutit Shqiptar të Medies, botuar në vitin 2018, me titull “Peizazhi I medieve online në Shqipëri”, i cili është një studim shumë i mirë. Unë ju kam vënë në dispozicion të gjitha studimet e tjera që janë kryer në Shqipëri. Janë për t’u lavdëruar organizatat e shoqërisë civile të specializuara në fushën që kanë bërë studime sistematike, sidomos në këto dy tre vjetët e fundit për mediet online. Në një këto studime theksohet fakti që nuk ka rregulla ligjore të detyrueshme për medien online në krahasim me median audiovizive, çka do të thotë se nuk ka kufij specifikë të përcaktuar në aspektin e profesionalizmit dhe të etikës. Anonimati, një tipar i pandashëm i internetit dhe rrjedhimisht i medias online, vendos një ton të ri dhe potencial për abuzimin në mediet online në krahasim me mediet tradicionale, ku zakonisht publiku lidh përmbajtjen me figurën dhe emrin.

Gjithashtu, unë do të përmendja rekomandimin 15 të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës, i njohur ndryshe ECRI, me titull “Mbi luftimin e fjalimeve të urrejtjes”, ku theksohet se përdorimi i gjuhës së urrejtjes duket se po rritet veçanërisht përmes formave elektronike të komunikimit, që zmadhojnë ndikimin e tij, por që masa e saktë e tij mbetet e paqartë për shkak të mungesës së raportimit sistematik dhe mbledhjes së të dhënave.

Lidhur me rastin e Shqipërisë, ne kemi një kuadër ligjor të përcaktuar në Kushtetutë, janë nenet 22 dhe 23, njëkohësisht në Kushtetutë në nenin 17, në paragrafin e dytë, përcaktohet kufizimi i të drejtave dhe lirive. Sipas Kushtetutës, duhet të përmbushim disa kritere të rëndësishme, si: interesin publik, mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe përpjesëtimi me gjendjen që ka ndikuar. Edhe në raportin dhe diskutimin që do të bëjë kolegja Bushka nen për nen, këto elemente të rëndësishme që parashikon Kushtetuta në nenin 17 janë marrë në konsideratë.

Pra, a ka një interes publik për të bërë një rregullim të medieve online? Në ç’raport do të jetë rregullimi në këtë ligj me vetërregullimin, i cili është një element shumë i rëndësishëm që ne

kemi ritheksuar në projektligj? A cenohet e drejta e lirisë së shprehjes, kur cenohen të drejtat e qytetarëve nga përdorimi i tepruar i lirisë së shprehjes? Elementi i tretë shumë i rëndësishëm që do të analizojë kolegja Bushka në pjesën e gjobave është: a ka një përpjesëtim?

Të nderuar kolegë, këtu kemi parë të gjitha vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në vitin 2019 ka tri vendime shumë të rëndësishme, madje kemi mbajtur në konsideratë edhe vendimin “Delfi kundër Estonisë”.

Ajo që doja të theksoja është se risia e parë që sjell ky projektligj ka të bëjë me kuadrin ligjor, që rregullohet me ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili pëson ndryshim. Çfarë konkretisht? Pikërisht zgjerohet fusha e zbatimit të ligjit. Deri tani ligji në fuqi rregullon mediat audiovizive duke përfshirë të gjithë ofruesit e shërbimeve medietike, por nuk kishte rregullim për ofruesit e mediejeve online. Pikërisht këto përfshin ofruesi i shërbimeve të mediejeve elektronike.

Së dyti, në ligj saktësohet qartë se kush është ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik dhe çfarë kuptojmë me publikimet elektronike. Do të doja të theksoja se për këto tri elemente kemi pasur konsulencë sistematike të ekspertëve të OSBE-së dhe janë bërë riformulime bazuar në rekomandimet e dhëna prej tyre. Zonja Bushka ka mbajtur kontakte të vazhdueshme.

Element tjetër i rëndësishëm është regjistri i ofruesve të shërbimeve mediatike, i cili mungon sot. Ky regjistër do të përmbajë të dhëna për ofruesit e shërbimeve audiovizive dhe elektronike. Pra, këto të dhëna janë të domosdoshme për të ditur se kush janë pronarët dhe a kanë një adresë apo jo.

Gjatë seancave dëgjimore ju i keni parë dhe dëgjuar që shpesh edhe në raste kur ka procedura administrative në gjykatë, gjykatat janë në pamundësi për të gjetur adresën e një medie, e cila mund të konsumojë veprime që përbëjnë elemente të një vepre penale. Mundësia për të pasur një proces të rregullt ligjor, për ta pasur përfaqësuesin e medias ose qytetaren që është viktimë, për ta adresuar rivendosjen e së drejtës së vet është e vështirë për shkak të mungesës së të dhënave. Megjithatë, ky regjistër nuk është i detyrueshëm, pra mosregjistrimi në këtë regjistër nuk është parakusht për të zhvilluar veprimtarinë.

Elementi i tretë i rëndësishëm është se projektligji parashikon rregulla të qarta procedurale për ofruesin e shërbimeve të publikimeve elektronike për të parandaluar cenimin e dinjitetit të individit, ekspozimin e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, sidomos pornografia, dhe

ekspozimin e qytetarëve nga gjuha e urrejtjes dhe dhuna, përfshirë këtu ekstremizmin e dhunshëm.

Pra, po të shikoni, kjo paketë, që njihet si paketa antishpifje, nuk është thjesht adresim i cenimit të të drejtave të njerëzve dhe të dinjitetit të tyre, por ka një mbrojtje shumë më të gjerë të lirive dhe të drejtave të njeriut, që burojnë jo vetëm nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, por edhe nga një sërë konventash të tjera në të cilat Shqipëria është palë, qoftë për mbrojtjen e fëmijëve, ose edhe për parandalimin e gjuhës së urrejtjes, ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet medieve online.

Gjithashtu, në këtë ligj i jepet shumë rëndësi respektimit të shprehjes dhe pluralizmit në tregun e medieve elektronike dhe vendos standarde etike në mënyrën si duhet të përmirësohet ofrimi i shërbimit audioviziv dhe ai elektronik.

Këtu është treguar kujdes që mediet online të vetërregullohen.

Edhe në diskutimin nën për nen AMA-s i kërkohet të hartojë një strategji në konsultim publik me të gjithë aktorët dhe ofruesit e këtyre shërbimeve për të pasur një strategji, e cila do të nxisë vetërregullimin dhe do të rregullojë në mënyrë të detajuar shumë probleme që hapen sot në lidhje me median online.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është mbrojtja e individëve nga lajme të rreme, ose dezinformimi. Për fat të mirë, kemi disa studime në Shqipëri, një studim është kryer nga Instituti Shqiptar i Medies dhe një studim i fundit, i botuar në vitin 2019, është studimi për shkeljet e etikës në media i kryer nga Këshilli Shqiptar i Medies. Është shumë interesante që edhe Shqipëria nuk bën përjashtim nga vendet e tjera të Europës lidhur me dezinformimin, i cili është kërcënim për demokracinë, për të drejtat e njeriut në të gjithë Europën, madje edhe në vendet anëtare të BE-së. Studimi ka treguar se nga numri i lartë i medieve, që janë rreth 700, vetëm 45, sipas studimit që unë citova, janë të regjistruara. Kjo tregon se shumica e medieve janë online dhe shpërndajnë informacion të pakonfirmuar dhe se numri i shkeljeve që kryejnë ato është i lartë.

Më lejoni të përmend studimin e Këshillit Shqiptar të Medias, i cili në një studim për periudhën gusht 2018-janar 2019 për 40 portale, ka gjetur shkelje në 35 portale dhe numri i përgjithshëm i shkeljeve është 1280 dhe shkeljet kanë një tendencë rritjeje nga shtatori në dhjetor. Mjafton ky tregues, pa përmendur studimin që kam cituar pak më lart për mediet online, ku thuhet se çdo ditë përgatitja e popullatës për të filtruar dhe kritikuar, siç duhet në këto medie është mjaft e ulët, madje indeksi i aftësisë për median i vitit 2018 e ka renditur Shqipërinë në vendet e fundit

në Europë në lidhje me gatishmërinë për të përballuar epokën e lajmeve të rreme, vetëm pak para Turqisë dhe Maqedonisë, për të thënë se kjo nismë e qeverisë ka ardhur në një kohë edhe si përgjigje për atë që thuhet indeksi i aftësisë për median në vitin 2018, që Shqipërinë e ka konsideruar të papërgatitur për të menaxhuar të gjithë dezinformimin dhe për të përgatitur popullatën për të filtruar të gjithë atë mori informacioni që transmetohet.

Ajo për të cilën është treguar kujdes në ligj është se, pavarësisht se ka disa procedura administrative për të përshpejtuar një proces kur cenohen të miturit nga pornografia, kur shpërndahen thirrje, të cilat shkaktojnë dezinformim, keqinformim, ose gjuhë urrejtje dhe nxisin racizmin dhe sigurinë publike, e drejta e ankimit në gjykatë të vendimit të Këshillit të Ankesave është parashikuar e zeza mbi të bardhë në ligj, ndonëse ju e dini se parimi i përgjithshëm, edhe po të mos e kishim vënë në ligj këtë, ekziston, sepse është parim që e kemi në Kodin e Procedurave Administrative dhe gjykata, edhe po të mos e ketë ligji, do ta kërkonte konsumimin e mjeteve administrative për të kaluar në ato gjyqësore.

Një risi tjetër e ligjit është mbrojtja e të miturve në publikimet online. Mbrohen të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç. Deri sot mbrojtja e të miturit në medie online nuk ka qenë e rregulluar. E konfirmojnë të gjitha studimet e bëra nga organizatat e medias, të specializuara në Shqipëri, por edhe në raportin e Kombeve të Bashkuara për zbatimin e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve dhe të konventave të Këshillit të Europës.

Pikërisht ligji për mediet audiovizive, siç është sot në fuqi, ka një rregull të përgjithshëm lidhur me komunikimet për qëllime tregtare, por nuk hyn në detaje se çfarë duhet bërë kur konstatohet që ka një ekspozim të fëmijës ndaj reklamave që janë shumë të dëmshme ose që mund të jenë pornografi online. Ju i keni dëgjuar organizatat që mbrojnë të drejtat e fëmijëve CRCA-në, UNICEF-in, Save the Children, që kanë kërkuar në mënyrë sistematike të merren masa për të fshirë në një kohë rekord të gjitha përmbajtjet pornografike në portale, të cilat janë të asksesueshme nga fëmijët.

Projektligji ka sjellë detyrimin të publikohet paralajmërimi i përshtatshëm për përmbajtjen e publikimit, që mund të dëmtojë zhvillimin fizik, shëndetësor, moral, intelektual dhe emocional të fëmijës, ndalimin e publikimit të informacionit dhe garantimin dhe mbrojtjen e fëmijës jo vetëm kur është viktimë në rastet e dhunës, por edhe kur është dëshmitar, edhe kur është person i dyshuar, edhe kur është shkelës i ligjit. Këtu ne përmbushim një detyrim tjetër që buron nga Kodi i

Drejtësisë Penale të të Miturve, nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe nga Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Pornografia Online.

Risia tjetër është parandalimi dhe ndalimi i gjuhës së urrejtjes në mediat online.

Të nderuar kolegë, në këtë komision ne kemi bërë ndryshime në vitet 2008, 2012, 2013, dhe jemi fokusuar më shumë teK ashpërsimi i Kodit Penal për krimet online, duke përdorur sistemin kompjuterik ose të gjitha format e tjera të komunikimit që nga botimet, piktura, pra në çdo formë që mund të kryhet komunikimi, por rekomandimi 15 i Komisionit European është kundër racizmit dhe intolerancës, ECRI, nuk e vë theksin te politika penale. Pra, dënimi penal duhet të jetë mjeti i fundit, por u kërkon autoriteteve, shteteve anëtare të tij të marrin masa duke përmirësuar ligjin civil, administrativ, duke rregulluar procedurat dhe duke vetinkurajuar medien të vetërregullohet.

E kam theksuar dhe po e theksoj se ky ligj nuk ndalon këtu, sepse mediet duhet të vetërregullohen më tej për shumë aspekte që trajtohen në ligj në mënyrë parimore. Në këtë kuadër, rekomandimet 7 dhe 15 të ECRI-t detyrojnë shtetet të marrin masa ligjore, civile, administrative dhe penale për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes. Këto rekomandime e vënë theksin te masat civile dhe administrative dhe konkretisht kërkojnë:

- Së pari, nevojën e qartësimit të përgjegjësisë ligjore dhe civile për përdorimin e gjuhës së urrejtjes.
- Së dyti, të përcaktojnë përgjegjësinë e veçantë të autorëve të gjuhës së urrejtjes, të ofruesve të shërbimeve të internetit, forumeve dhe organizatorëve në internet, ndërmjetësve në internet, platformave të mediave sociale, moderatorëve të faqeve personale që të marrin masa të parandalojnë gjuhën e urrejtjes, se kur ka krim urrejtjeje ka edhe përgjegjësi penale.
- Së treti, rekomandimi 15 kërkon mundësinë e disponueshmërisë së kompetencave në varësi të autorizimit ose miratimit gjyqësor, si dhe fshirjen e gjuhës së urrejtjes nga materiali i arritshëm në internet, bllokimin e faqeve që përdorin gjuhën e urrejtjes, për ta ndaluar shpërndarjen e saj dhe për të detyruar zbulimin e identitetit të atyre që e përdorin atë.
- I fundit, rekomandimi 15 i ECRI-t kërkon të sigurohet mbështetje për ata që cenohen nga fjalimi i urrejtjes, pra për viktimat që në përgjithësi janë minoritete, personat për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor, për shkak të besimit fetar e të tjerë.

Pikërisht, projektligji përmban rregulla të përgjithshme lidhur me detyrimin që ka ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik të mos nxisë, shtojë dhe të mos përhapë urrejtje dhe, në rast se

ka gjëra të tilla, t'i fshijë menjëherë dhe të kërkojë falje. Pa dyshim, kur ky ligj ka përgjegjësi penale, vepron Kodi Penal.

Gjëja e fundit që do të doja të theksoja është mbrojtja e së drejtës së autorit. Studimet që janë bërë në Shqipëri janë shumë interesante dhe unë këtu do të përmendja një anketim të bërë nga Instituti i Medies me pronarët e portaleve. Një nga problemet më të mëdha që nxorën ka qenë e drejta e autorit. Ne kemi miratuar ligjin nr. 35 të vitit 2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera lidhur me të”. Anketimi i përfaqësuesve të medies ka nxjerrë si problem kryesor shkeljen e të drejtës së autorit, pasuar nga mungesa e raportimit cilësor. Pikërisht, projektligji adreson probleme që lidhen me të drejtën e autorit në transmetim, ritransmetim, përfshirë edhe në mediet *online*.

Shumë interesant është edhe një studim tjetër, të cilin unë dhe koleget Bushka dhe Ekonomi e kemi mbajtur në konsideratë, i kryer nga Instituti Shqiptar i Medies për treguesit e Këshillit të Europës për mediet në demokraci. Në këtë projektligj kemi marrë në konsideratë të gjithë treguesit se si matet media në demokraci, procesin e vetërregullimit të profesionit të gazetarëve, i cili, sipas këtij studimi, në Shqipëri është shumë larg standardeve ndërkombëtare të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave. Megjithëse ka një Kod Etike dhe kode të tjera, zbatimi i tyre në praktikë lihet në dorë të gazetarëve dhe në rastet e medieve *online* Kodi i Etikës pothuajse nuk zbatohet. Pikërisht këto gjetje të këtij studimi, por edhe treguesit e medies në demokraci, tregues të përpunuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, i kemi mbajtur në konsideratë në ridraftimin e disa neneve të projektligjit të sjellë nga qeveria. Këtu kemi pasur parasysh të gjitha rekomandimet që janë sjellë nga OSBE-ja, nga Bashkimi European, nga Këshilli i Europës por edhe nga të gjitha diskutimet që janë bërë në seancat dëgjimore. Me këtë rast, do të doja të falënderoja të gjithë të pranishmit në seanca dëgjimore, pavarësisht se mund të ndajmë mendime ndryshe, por konsultimi publik nënkupton që ne duhet të debatojmë, të diskutojmë dhe të marrim në konsideratë pikërisht ato çfarë janë në përputhje me standardet.

Pa dyshim, ky ligj nuk mund të ndalojë që organizatat e medieve dhe mediat *online* të rrisin cilësinë, trajnimet, kualifikimet apo të miratojnë Kodin Etik. Vetëm pak portale, thuhet në studimin e Institutit Shqiptar të Medies, kanë miratuar dhe respektojnë Kodin Etik. Pjesa më e madhe e portaleve nuk e kanë Kodin Etik, madje dhe mediat tradicionale që kanë faqe *online*, nuk e respektojnë atë dhe as e kanë miratuar, megjithëse AMA dhe vetë gazetarët kanë miratuar disa

parime dhe standarde për të rregulluar atë vakum ligjor që ka ekzistuar deri më sot lidhur me mediet *online*.

Për sa i përket çështjes së vetërregullimit në media, e kemi theksuar që treguesi i medies në demokraci, hartuar nga Këshilli i Europës, është marrë në konsideratë. Po e ritheksoj, ka disa paragrafë ku theksojmë dhe inkurajojmë median të vetërregullohet për shumë aspekte që parashikon ligji që kemi në diskutim.

Për sa u përket masave për shkeljet e kryera, në detaje do të flasë kolegja Bushka, por do të doja të theksoja se neni 132 ka qenë neni më i diskutuar në konsultimin publik me ekspertët ndërkombëtarë, me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e medies. Këtu kemi pasur parasysh edhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut. Në diskutimin dhe rishikimin e tij ne kemi pasur parasysh treguesit e Këshillit të Europës për mediet në demokraci, konkretisht që gazetarët nuk mund të dënohen me burg dhe po ashtu organet e medies nuk duhet të mbyllen si pasojë e opinioneve dhe komenteve kritike.

Gjithashtu, nuk ka asnjë mbrojtje të veçantë të personave politikë dhe zyrtarë, duke përmbushur kështu edhe një tregues tjetër të medies në demokraci që personat zyrtarë janë më të ekspozuar ndaj kritikave dhe nuk mund të kenë mbrojtje si qytetarët e zakonshëm për kritikën që u bëhen, për mënyrën se si qeverisin, për mënyrën se si punojnë në sektorët e tyre. Po kështu, edhe për ne në parlament. Ky ligj nuk zbatohet ndaj nesh. Nëse ndaj nesh ka kritika për fjalimet dhe diskutimet, ne nuk mund të bëjmë ankim te bordi i ankesave dhe të kërkojmë që të fshihet komenti, sepse ju e dini që transmetimet janë *online* dhe për gjithçka që konsumohet aty, jemi ne vetë përgjegjës për ato që themi në seanca, mbledhje, fushata apo veprimtari politike, ndaj ne nuk kemi imunitet, madje jemi më të ekspozuar dhe duhet të jemi më tolerantë në raport me të tjerët.

Në këtë kuadër do të doja t'ju falënderoja të gjithëve për bashkëpunimin!

Te raporti keni në transparencë dhe të detajuar të gjithë listën e organizatave dhe aktorëve të ftuar në konsultimin publik. Më vjen keq ta them se kemi pritur të kishte më shumë gjëra konkrete. Ne e dimë që këto ligje kanë ndjeshmëri, sikurse ky ligj ka pasur ndjeshmëri kur ka kaluar në Gjermani, Francë, Kroaci, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, në Komitetin e Ministrave, në Komitetet e Këshillit të Europës e të tjerë, sepse po përballemi me një zhvillim të vrullshëm të medies *online*. Mos harroni që shumë shpejt do të merremi edhe me inteligjencën artificiale dhe mbrojtjen e të drejtave të njerëzve.

Zonja Bushka së bashku me grupin e juristëve me të cilët po punon, po përgatisin një rezolutë për inteligjencën artificiale, çka do të thotë se shumë shpejt do të duhet të reagojë edhe Shqipëria në Asamblenë Parlamentare. Ndaj, të nderuar kolegë, duhet të jemi më të hapur, të zgjerojmë dhe të forcojmë bashkëpunimin me përfaqësuesit e medieve për t'u informuar, për të përmirësuar dhe bërë të gjitha ndryshimet e mundshme ligjore, por mbi të gjitha për të informuar publikun dhe për të nxitur medien të vetërregullohet.

E fundit, zoti kryetar, do të më lejon të theksoj se gjatë kësaj periudhe kam ndjekur të gjitha diskutimet dhe komentet që janë bërë lidhur me pozicionin e Komisionit të Ligjeve dhe parlamentit në këtë paketë ndryshimesh. I mirëkuptoj përfaqësuesit e medieve, i kam mirëpritur komentet dhe sugjerimet e tyre, por nuk mendoja se në këtë paketë kaq të rëndësishme nuk do të kishin mendime konkrete. Çfarë do të ndryshojmë dhe si duhet ta ndryshojmë?

E them këtë, sepse praktika e Këshillit të Europës është e re, pra edhe ata janë përballë një procesi të ri, por praktika sidomos është e pasur. Ne kemi disa gazeta medie *online* shumë cilësore që drejtohen nga njerëz të formuar në Europë e përtej saj, çka do të ishte shumë e dobishme që mendimet dhe sugjerimet e tyre të ishin konkrete dhe të mos thoshin: “Tërhiquni! Çojeni ligjin mbrapsht, e të tjerë”. as Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, as Komiteti i Ministrave dhe as konventat nuk thonë që media *online* mund të bëjë çfarë të dojë dhe si të dojë dhe se liria e shprehjes prevalon në raport me të drejtat e grupeve të tjera, siç është diskriminimi i minoriteteve ose i grupeve të tjera të dobëta në shoqëri.

Faleminderit për vëmendjen! Ndjesë që e zgjata, por ky është një ligj që kërkon vëmendje. Besoj se në raportin për dhënie mendimi që do t'i kalojë Komisionit të Medias, që është komision përgjegjës, do të gjeni të gjitha sugjerimet përkatëse, shumë informacione dhe adresime nga studimet dhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi, për këtë raportim në parim të kësaj pakete që e kemi quajtur “Paketa antishpifje”. Kolegët e kanë quajtur kështu, por ky është një ligj që nuk ka të bëjë fare me cenimin e lirisë së shprehjes, sepse është një ligj kryesisht procedural që rregullon veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike.

Më lejon të jem i qartë për një gjë, pas raportimit të koleges Hysi, kjo paketë rregullon kryesisht veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike, nuk prek dhe as rregullon veprimtarinë e rrjeteve sociale. Është as më shumë dhe as më pak, një shtim i objektivit të

punës së Autoritetit të Medieve Audiovizive që në ligj do të quhet Autoriteti i Medieve Shqiptare. Deri më sot ka pasur rregullimin e veprimtarisë së mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, tashmë do të ketë si shtesë të objektit të punës së vetë edhe shërbimet e publikimeve elektronike. Unifikon standardet dhe procedurat dhe nuk merret absolutisht me kontenit e lajmit. Për këtë e kemi sqaruar që në fillim se në finale është gjykata.

Jemi në fazën e diskutimeve në parim dhe më lejoni të bëj të ditur që prezent në këtë mbledhje kemi edhe nënkryetaren e Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, zonjën Milva Ekonomi, e cila është prezent sot bashkë me ne për të ndjekur të gjitha opinionet ligjore që do të diskutohen në parim, por edhe nen për nen për të dyja projektligjet, për të pasur një panoramë të qartë edhe për kolegët e komisionit që drejton, duke qenë se grupi i punës që ka punuar për këtë paketë ka qenë një grup pune unik nga të dy komisionet që nga dita e parë e deri më sot.

Më vjen mirë që janë dy projektligje në procedurë parlamentare që në korrik të vitit 2019, të cilët kanë marrë të gjithë kohën e nevojshme dhe unë jam besimplotë që produkti që do të miratojmë sot në Komisionin e Ligjeve dhe më pas te komisioni përgjegjës, do të jetë një produkt cilësor.

Kush e do fjalën nga kolegët për diskutime, nëse ka? Nëse nuk ka diskutime, mund të kalojmë në miratimin në parim dhe më pas nen për nen mund ta marrin fjalën kolegët për të diskutuar.

Fakti që në dëgjesat që kemi zhvilluar janë ezauruar të gjitha shqetësimet që kanë pasur kolegët deputetë, por jo vetëm, na e ka bërë më të lehtë edhe fazën e diskutimit në parim, ndaj unë mendoj të fokusohemi drejtpërsëdrejti në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen, aty ku do të ketë edhe ndërhyrje konkrete.

Kalojmë në votimin në parim për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim projektligji.

Siç u dakordësuam, relatorja Bushka do të ndjekë në dinamikë të gjitha nenet që do të kalojnë për votim në këtë ligj në variantin e tekstit integral që keni mbi tavolinë, të nderuar kolegë. Te tabela do të gjeni projektligjin e depozituar nga Këshilli i Ministrave dhe draftin e ripunuar me propozimet e grupit të punës, nga relatorët e Komisionit të Ligjeve, si dhe Komisionit të Edukimit

dhe Medies duke reflektuar edhe opinionet e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë. Pra, kolona bashkëngjitur është teksti integral që unë do të hedh për votim nen për nen, ku janë reflektuar të gjitha sugjerimet dhe komentet që janë marrë në konsideratë nga grupi i punës.

Ndaj, do të ftoja zonjën Bushka të më ndjekë. Zonja Bushka, para se të filloj me votimin nen për nen, do të doja të bëje disa sqarime lidhur me mënyrën e procedimit të votimit.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Ne kemi ecur në këtë mënyrë duke riformuluar nenet përkatëse të propozuara në nismat që kanë ardhur nga Këshilli i Ministrave për lehtësi për t'u kuptuar nga të pranishmit në mbledhje, nga anëtarët e komisionit, nga përfaqësuesit e nismëtarit, por edhe nga publiku. Unë do të doja që për çdo nen, atje ku është e nevojshme, të referojmë arsyen e ndryshimit dhe cilat janë komentet e ekspertëve ndërkombëtarë, të cilat në parim janë pranuar të gjitha. Pra, në amendimet që do të miratojmë sot në tekstin sipas versionit integral që ju keni para, janë pranuar të gjitha rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të paraqitura, të grupit të punës gjatë shqyrtimit në mbledhjet e përbashkëta të relatorëve dhe anëtarëve të Komisionit të Ligjeve, por edhe të Komisionit të Medias dhe atij të Veprimtarisë Prodhuese.

Pa humbur kohë, flasim konkretisht nen për nen, zoti kryetar.

Ulsi Manja – Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Do të kërkoja nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, AMA-s dhe Ministrisë së Infrastrukturës, por edhe të AKEP-it të shprehen për dakordësinë e ndryshimeve nen për nen.

Kalojmë te neni 1.

Fjala për zonjën Bushka.

Klotilda Bushka – Duke qenë se në rrethin e subjekteve të ligjit, përveç medieve që ofrojnë shërbime audiovizive, janë shtuar edhe mediet që ofrojnë shërbime të publikimeve *online*, titulli i ligjit do të ndryshohet nga ai që është në: “Për shërbimet e medies në Republikën e Shqipërisë” dhe këtu dua të saktësoj për publikun që shtypi i shkruar nuk është pjesë e zbatimit të parashikimeve të këtij ligji.

Ulsi Manja – Pra, relatorja propozon që titulli i projektligjit nga “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të bëhet “Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë”.

Kush është dakord me ndryshimin e titullit?

Klotilda Bushka – Nuk bëhet fjalë për përjashtim, por detyrimet që parashikohen për publikimet online nuk do të zbatohen për shtypin e shkruar. Pra, për gazetatat, sepse kemi një ligj të veçantë që rregullon shtypin e shkruar dhe ky është edhe rekomandimi ndërkombëtar.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 2.

Klotilda Bushka – “Objekti i ligjit” është e njëjta logjikë siç ju shpjegova te neni 1, pra shtohet “Objekti i ligjit” për sa kohë kemi shtuar publikimet elektronike.

Ulsi Manja – Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 3 “Fusha e zbatimit”.

Klotilda Bushka – Për sa kohë në ligjin aktual në fuqi është e parashikuar shprehja që ky ligj nuk zbatohet për medien e shkruar dhe në versionin e paraqitur kjo fjali nuk ekziston, ne jemi dakord me propozimin e paraqitur nga nismëtarët, por duke shtuar fjalën, që, në fakt, është në ligjin ekzistues dhe në versionin integral është riformulimi i ri në nenin 3.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Jeni dakord ju të Ministrisë së Drejtësisë, të AMA-s?

E hedhim në votim nenin 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 4.

Klotilda Bushka – Duke qenë se kemi ndryshuar edhe objektin, edhe fushën e zbatimit të ligjit, lind nevoja edhe për ndryshimin e emrit të Autoritetit të Medieve Audiovizive në “Autoriteti i Medieve Shqiptare”, nuk do të ndryshojë akronimi AMA për efekt të përdorimit të termit në gjuhën angleze. Kemi vendosur që Autoriteti i Medieve Shqiptare do të shkruhet kështu në ligj dhe në kllapa do të jetë AMA.

Gjithashtu, neni parashikon një sërë ndryshimesh në lidhje me shtimin në fushën e zbatimit të këtij ligji të shërbimeve të publikimeve *online* dhe ndryshon nga versioni i paraqitur termi “Media elektronike” në “Shërbimet e publikimeve elektronike”, sipas propozimit që është paraqitur nga ekspertët e OSBE-së dhe në të gjithë draftin do të përdoret ky term “Shërbimet e publikimeve elektronike”. Gjithë pjesa tjetër e shtjellimit në nenin 4, i cili parashikon ndryshime në nenin 3 të ligjit aktual, ka të bëjë me zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit në lidhje me këtë çështje.

Nga ekspertët e huaj nuk ka ndonjë koment tjetër, përveç faktit që të ndryshohet termi i mëparshëm “Për shërbimet e publikimeve elektronike”, të hiqet përdorimi i termit “media outlet” në këtë paragraf.

Gjithashtu, në pikën 26/1 në lidhje me publikimin elektronik të shtohet paragrafi: “Publikimet elektronike të bëra nga individë, që nuk kanë përmbytje të formësuar editorjale dhe nuk kanë si qëllim edukimin, argëtimin apo informimin për publikim, nuk konsiderohen publikime elektronike në kuptimin e këtij ligji”. Kjo është për të kuptuar që jo çdo publikim elektronik mund të përmbajë elementet dhe kriteret e shërbimeve të publikimeve elektronike, sipas parashikimeve të këtij ligji në përputhje me standardet ndërkombëtare. Tekstin e keni përpara, prandaj unë ju sugjeroj ta kalojmë me këtë përmbytje, për sa kohë kemi marrë komentet e ndërkombëtarëve dhe i kemi inkorporuar në këtë draft.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Zoti Beja, a jeni dakord me nenin 4, me sugjerimet që janë bërë në tekst?

Besmir Beja – Dakord. Si vlerësim teknik është i pasur, me gjithë vështirësitë që paraqet në zbatimin në praktikë. Ruajtja akoma e akronimit AMA duket sikur të krijon përshtypjen e një vlerësimi, i cili vjen nga anglishtja dhe teknikisht duhet të reflektohet ndryshimi i emrit.

Nga ana e teknikës legjislative kjo është një çështje që rregullohet kollaj, sepse në çdo vend ku është parashikuar ky akronim në ligjit mund të përdoret ky lloj reflektimi. Unë mendoj se kjo mund të krijojë në praktikë probleme, por kjo është në vlerësim tuaj nëse duhet reflektuar vetëm për hir të reflektimit teknikës legjislative në ligj apo mund të ruhet për shkak të problematikave që mund të shkaktojë në të ardhmen.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Beja!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, dua të përshëndes, në kuptimin e ngushtë të termit, heqjen e disa termave, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me gjuhën shqipe, pavarësisht se termi “media outlet” nuk ka lidhje me këtë aspekt. Unë ftoj relatoren të mbrojë gjuhën tonë të dliër nga disa terma të futur nga njerëz që përpiqen të hiqen si të zgjuar dhe nuk shikojnë fjalorin e gjuhës shqipe, sepse gjuha shqipe ka terma shumë të saktë.

Ne e kemi bastarduar gjuhën tonë, duke futur elemente nga anglishtja, latinishtja, greqishtja dhe në 500 vjet nga turqishtja, pastaj themi që e duam gjuhën dhe kombin, por në të vërtetë nuk e duam fare. Këtu më me faj është medie! Edhe unë sapo përdora një term të gabuar, sepse fjala “medie” nuk është shqip, por janë mjetet e komunikimit të të gjitha formave.

Ky është rasti për t’u dhënë një mesazh vetë medieve dhe publikut që ne e duam gjuhën. Ftoj relatoren që në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të përcaktojnë termat e duhur shqip për shumë elemente.

Kur e lexova ligjin, aty gjeta termat “*pop up*” dhe “*broadcast*”, të cilat nuk mund të jenë në një ligj shqip. Këta terma mund të jenë në çdo material teknik, por jo në një ligj. Këto ligje mund të qëndrojnë me dhjetëra vite, unë uroj me qindra, por le ta shkruajmë në gjuhën e nënës sonë të ëmbël dhe të dashur, në gjuhën shqipe. Këtë ndërhyrje e kam parimore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ky shqetësim duhet të reflektohet edhe nga shërbimet e Kuvendit në momentin e draftimit dhe redaktimit të tekstit të projektligjit, përpara votimit në seancë, por gjithsesi qëndron si vërejtje.

Kush është dakord me nenin 4, me sugjerimet e bëra nga kolegja Bushka? Kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Neni 5. Ky nen ndryshon nenin 4, pra titulli i nenit 4 ndryshohet. Parimet themelore të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve medietikë. Në pikën 2 të nenit 4 fjala “audioviziv” zëvendësohet me fjalët “te medies elektronike”.

Zonja Bushka, këto janë ndryshimet për nenin 5?

Klotilda Bushka – Po.

Ulsi Manja – Nuk ka të tjera?

Klotilda Bushka – Jo. Logjika e të gjitha ndryshimeve ka të bëjë me përdorimin e terminologjisë. Në thelb nuk ka ndryshime.

Ulsi Manja – Dakord. Zoti Beja, a jeni dakord me nenin 5?

Besmir Beja – Dakord.

Ulsi Manja – Kush është pro? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Neni 6, “Interpretimi i ligjit”.

Zonja Bushka, a ka ndryshime në këtë nen?

Klotilda Bushka – Është thjesht teknikë legislative.

Ulsi Manja – Nuk ka ndryshime neni 6.

Po, zoti Beja.

Besmir Beja – Kërkoj ndjesë, në vlerësimin tim përdorimi i fjalës “duhet” në këtë rast, duket sikur në raste të caktuara ky ligj mundet të interpretohet sikur jep të drejtën për të censuruar apo kufizuar të drejtën e lirisë së fjalës.

Ulsi Manja – A ka propozim?

Besmir Beja – Zgjidhja është që të jetë ashtu siç ishte me fjalën “mund”, pra “dispozitat e këtij ligji nuk mund të interpretohen”. Gjithashtu, në rast se themi “nuk duhet të interpretohen”, duket sikur ka raste që edhe mund të interpretohen.

Klotilda Bushka – Dakord.

Ulsi Manja – Dakord. Kush është dakord me nenin 6, me sugjerimin e zotit Beja? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7. Ndryshimi i titullit të kreut II, Autoriteti i Medieve Shqiptare (AMA). Kush është dakord me nenin 7? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8.

Zonja Bushka, a ka ndryshime neni 8?

Klotilda Bushka – Jo, nuk ka, janë thjesht dy formulime të teknikës legislative dhe është hequr termi “shërbimet mbështetëse të tyre”, duke u nisur edhe nga komentet e OSBE-së. Ky nen parashikon saktësimin e organeve vendimmarrëse të AMA-s, që janë bordi dhe Këshilli i Ankesave, për të cilat do të flasim në nenet vijuese.

Ulsi Manja – Po, ju lutem.

Sara Xhumbari – Kemi një koment të vogël në pikën 1 lidhur me ndryshimin që propozohet. Në vlerësojmë që dispozita duhet të rrijë siç është në fuqi dhe të shtohet fjalia e

propozuar “në fushën e shërbimeve të medias elektronike”. Kjo pasi Autoriteti i Medieve është kompetent edhe për lëshimin e licencave të transmetimit, që përfshin rrjetin dhe programin. Ndërsa propozimi duket sikur e kufizon fushën e zbatimit të AMA-s.

Gjithashtu, propozojmë që edhe shërbimet mbështetëse si koncept duhet të qëndrojnë, pasi Autoriteti i Medieve në disa dispozita të ligjit është kompetent edhe për lëshimin e autorizimeve. Për shembull, autorizimet e shërbimeve të mbrojtura. Pra, ne vlerësojmë që dispozita të qëndrojnë ashtu siç është dhe propozimi: “Në fushën e shërbimeve të medias” të shtohet në fund të pikës.

Ulsi Manja – Pra ju kërkoni që pika 1...

Sara Xhumbari – Pika 1 të riformulohet.

Ulsi Manja – “AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të medias elektronike dhe të shërbimeve të tyre mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Sara Xhumbari – Po e riformuloj: “AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio e audiovizive, shërbimeve të tjera mbështetëse të tyre dhe shërbimeve të medias elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë”. Pra, dispozita të jetë ashtu siç është dhe të shtohet propozimi.

Ulsi Manja – Pra, të kemi atë objekt që kishim dhe të shtohet “shërbimet e medias elektronike”?

Sara Xhumbari – Po.

Ulsi Manja – Ky është edhe qëllimi i ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, sugjerimi është vetëm për pikën 1.

Atëherë pranohet sugjerimi për pikën 1 të nenit 8 dhe pika 2 ngelet ashtu siç është në draftin e riformuluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Kush është dakord me nenin 8, me ndryshimet e propozuara? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9.

Klotilda Bushka – Për efekt të ndryshimit të termave në draftligj, në nenin 9 do të bëhen ndryshimet përkatëse “kryetari i AMA-s” zëvendësohet me fjalët “kryetari i bordit të AMA-s”. Pra, kudo që është e shënuar “kryetari i bordit të AMA-s, është bërë reflektimi i ndryshimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Mungesë incizimi)

Është njësoj si dy nenet e mëparshme. Bazuar në propozimet e ekspertëve të OSBE-së, neni 12 shtohet në mënyrë që të ndryshohet neni 13 i ligjit dhe kudo në tekst fjalët “AMA” dhe “vendimet e AMA-s” do të zëvendësohen me fjalët “mbledhjet e bordit të AMA-s” dhe “vendimet e bordit të AMA-s”.

Kolegu Hyseni ka një sugjerim me të drejtë, i cili thotë që në kuadër të shqetësimeve, në parim të përdorim sa më shumë fjalë shqip, ndoshta duhet t’ia rekomandojmë komisionit përgjegjës që fjala “bord” të zëvendësohet me fjalën “këshill”. Megjithatë, ky është një sugjerim.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 12? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord me nenin 13? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Neni 14.

Po.

Klotilda Bushka – Këtu janë disa ndryshime që shkojnë në linjë me natyrën e ndryshimeve të paraqitura nga nismëtarët, janë përfshirë sugjerime të grupit të punës, të cilat lidhen me propozimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili shtohet si institucion përgjegjës në kuadër të bashkëpunimit që ka AMA për çështjen e fushës së zbatimit të këtij ligji. Gjithashtu, janë hequr fjalët “outlet media”, të cilat janë zëvendësuar me fjalët shqip “për shërbimet e publikimeve” dhe i gjithë formulimi i paragrafit sipas nismëtarëve është në linjë me qëllimin që ka projektligji.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Po, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë dhe të tjerët me radhë.

Besmir Beja – Kam një koment për çështjen e teknikës legjislativë, në shkronjën “j” propozohet që në çdo rast në emërtesën e organit ose në çdo lloj rasti të referohet organi përgjegjës që mbulon këtë lloj fushe, si për shembull, kemi parashikuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mund të thuhet: “Autoritetin ose Komisionerin përgjegjës për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në rast se vendoset për t’i quajtur të gjitha organet me emrin e tyre, mbas Autoritetit përgjegjës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Autoritetit përgjegjës për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit të referohen me emrat e tyre konkretë.

Ulsi Manja – Jemi dakord.

Përfaqësuesja e AMA-s, ka ndonjë gjë për të shtuar?

Sara Xhumbari – Në germën “k” të nenit 14, nuk po e lexoj të gjithë fjalinë, pas fjalëve “trajtimin e ankesave të parashtruara pranë KA-së dhe Bordit të Administrimit”, Bordi i Administrimit është strukturë që nuk trajtohet më tej në ligj, mbase fjala ka qenë për bordin e AMA-s? Pra duhet saktësuar fjala “administrimi”.

Ulsi Manja – Po, duhet të hiqet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord jemi. Kjo është e zbardhur në tekstin e projektligjit dhe do të hiqet.

Në nenin 14 pranuar një sugjerim të teknikës legislative për germën “j” të nenit 14 nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë dhe sugjerimin e bërë nga përfaqësuesja e AMA-s për të hequr fjalët “bordit të administrimit” në germën “k”, ndërsa për pjesën tjetër jemi dakord me relatoren. Kush është dakord me nenin 14? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15.

Po.

Klotilda Bushka – Ky është një nen shumë i rëndësishëm dhe për këtë ka pasur shumë diskutime, nisur nga ndjeshmëria e grupeve të interesit, përfaqësues të medieve dhe shërbimeve të publikimeve *online*.

Për sa i takon Këshillit të Ankesave, janë ngritur shumë shpesh dyshime subjektive dhe objektive në lidhje se sa i pavarur do të jetë ky këshill, i cili do të shqyrtojë ankesat e subjekteve që pretendojnë se janë cenuar nga dezinformimi apo nga lajme të pavërteta, për sa kohë që ky këshill krijohet me vendim të AMA-s. Në shqyrtim të përmbajtjes së nenit përkatës që flet për Këshillin e Ankesave, kemi vlerësuar, edhe në harmoni me parashikimet e ligji aktual në fuqi, se Këshilli i Ankesave garanton pavarësi. Por për ta rritur efektshmërinë e kësaj pavarësie kemi sugjeruar, edhe në tekstin që keni përpara, një amendim ku themi: “Procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Ankesave bazohen në rregullat e konkurueshmërisë. Rregullorja e organizimit dhe funksionimi i tij përcaktohet me vendim të AMA-s”. Kjo do të thotë që bordi i AMA-s apo këshilli i AMA-s nuk do të caktojë thjesht disa anëtarë në këtë këshill, por do të duhet të hapë një procedurë gare me kritere të qarta dhe me procedura transparente. Përfaqësues në këtë këshill duhet të jenë specialistë të fushës së medias, por ne kemi sugjeruar që të shtohet edhe një

jurist, sepse kemi të bëjmë me të drejta. Këto janë propozimet tona, sipas formulimit që keni në tekstin e paraqitur.

Ulsi Manja – Për nenin 15 përfaqësuesi i AMA-s ka një sugjerim.

Gentian Sala – Zoti kryetar, ne nuk kemi ndërhyrë kur ishte diskutimi në parim, pasi është marrë vendimi që bordi i AMA-s e ka hedhur poshtë në parim ligjin. Meqenëse jemi te nenet specifike që prekin punën tonë të përditshme...

Ulsi Manja – Për këtë jeni sot këtu.

Gentian Sala – ...mendojmë të mos ndryshohet mënyra se si është konceptuar Këshilli i Ankesave. Ai është konceptuar me gazetarë, të cilët kanë 10 vjet eksperiencë, pasi funksionet e tjera i përmbushë administrata e AMA-s dhe vetë bordi i AMA-s, i cili është miks. Në bordin e AMA-s ka juristë, publicistë, gazetarë, kurse për Këshillin e Ankesave ligji e thotë specifikisht që duhet të jenë gazetarë me 10 vjet eksperiencë, po u fut edhe një jurist, atëherë do të kthehet pak a shumë si një organ administrativ rutinë. Unë nuk e gjykoj që duhet, për më shumë duke pasur parasysh që në të gjitha diskutimet e këtij ligji ka një ndarje shumë të thellë mes personave me *background* juridik dhe gazetarëve. Pra, Këshillin e Ankesave t’ua lëmë gazetarëve me 10 vjet eksperiencë. Zgjedhja e këtyre anëtarëve ka qenë shumë transparente.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Sala!

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Zoti Sala, jemi dakord. Ju e keni më të qartë nga praktika se si do ta garantojë çështjen e efektshmërisë pavarësia e këtij këshilli. Për ne nuk ka rëndësi përbërja, por rëndësi ka se si do të përzgjidhen anëtarët, që sigurisht duhet të jenë nga sektori i medias, sektori i shërbimeve audiovizive apo i publikimeve *online*, duke zbatuar parimin e konkurueshmërisë me kriteret të qarta, me garë dhe me procedura transparente. Pra, në fund të ketë një sistem meritokracie në përzgjedhjen e tyre dhe jo emërim. Pra, nëse mendoni që anëtarët duhet të jenë vetëm nga fusha e medias, ne e tërheqim propozimin tonë për juristë dhe formulimi të vazhdojë vetëm me shtesat për sa u takon rregullave të konkurueshmërisë në përzgjedhjen e anëtarëve të këtij këshilli.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Po.

Gentian Sala – Në vlerësimin tim, në vend të fjalëve “i cili caktohet” duhet të jenë fjalët “të cilët përzgjidhen”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Dakord. Hedhim në votim neni 15 me dy ndryshimet në pikën 1 të këtij neni, te Këshilli i Ankesave fjala “caktohet” zëvendësohet me fjalën “përzgjedh” dhe aty ku thuhet “4 anëtarë specialistë të fushës së medias dhe juristë” hiqen fjalët “dhe jurist” dhe lihet vetëm “specialistë të fushës së medias”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sepse ofrojnë shërbimet juridike të AMA-s dhe bordi ka në përbërje juristë.

Zoti Alimadhi, t’i lëmë mediet te fusha e tyre, sepse ka juristë sa të duash.

Adriatik Alimadhi – *(Flet pa mikrofon)* ...nisur nga Këshilli i Ankesave, vetë ankesat në përmbajtje kërkojnë që të ketë një jurist, ndryshe nuk ka kuptim.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 15, me dy ndryshimet e vogla të pikës 1? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. A ka ndryshime ky nen?

Klotilda Bushka – Jo nuk ka, vetëm riformulime të teknikës legislative.

Ulsi Manja – Nuk ka. Kush është dakord me nenin 16? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. As ky nen nuk ka ndryshime.

Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. As ky nen nuk ka ndryshime.

Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. A ka sugjerime për këtë nen?

Klotilda Bushka – Po ka. Zoti kryetar, dua të bëj një saktësim, kur thoni: “Nuk ka ndryshime” do të thotë që nuk ka ndryshime nga teksti që u kemi paraqitur kolegëve.

Ulsi Manja – Sigurisht nga teksti integral.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Çyrbja, mbani qetësi. Kur unë them që nuk ka ndryshime, i referohem tekstit integral të projektligjit që ju, të nderuar kolegë, keni mbi tryezën e punës.

Klotilda Bushka – Ndërkohë që grupi i punës, për sa i takon nenit 19, i cili flet për ndryshime në nenin 30 të ligjit aktual, ka bërë disa propozime, të cilat më shumë janë të teknikës legislative dhe nuk ka ndryshime në thelb.

Ulsi Manja – Atëherë, a jeni dakord me relatoren për nenin 19? Kush është pro? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Ky nen nuk ka ndryshime sipas tekstit integral. Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Nuk ka ndryshime. Kush është pro? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Për këtë nen do të shprehet përfaqësuesja e Ministrisë së Infrastrukturës.

Irena Malolli – Meqenëse neni 20 klasifikon të gjitha llojet e shërbimeve, është mirë që të mbetet “e shërbimeve medietike”, ndërkohë që bëhet zëvendësimi i fjalës “mediatike” me “media elektronike”. Pra pika 1, titulli i nenit 31 të ndryshohet si më poshtë: “Llojet e ofruesve të shërbimit të medias elektronike...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Më fal, të lutem, por neni 20 është: “Titulli i nenit 31 ndryshohet si më poshtë: “llojet e ofruesve të shërbimeve medietike”. Pra, është në rregull.

Irena Malolli – Dakord, është gabim në tabelë.

Ulsi Manja – Po, është një lapsus.

Neni 22. A ka komente për këtë nen? Nuk ka. Kush është pro? Kundër? 1 votë, zoti Alimadhi. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, neni 22 “Pas nenit 33 shtohen nenet 33/1 dhe 33/2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Dua të bëj një sqarim, sepse teksti është në rregull. Pra neni që sapo e miratuam nuk ka ndonjë ndryshim në thelb, nuk ka ndonjë ndryshim në thelb.

Versioni që kemi miratuar, i riformuluar, parashikon përfshirjen e komenteve të ekspertëve të OSBE-së, ku hiqen dy pika, hiqen disa përkufizime të parashikuara në pikën 3 të neni 33/1, që kanë të bëjnë me besimin politik.

Kemi hequr anëtarësimin në sindikata në të njëjtën pikë. Ndërkohë, ka disa rregullime të teknikës legjislative.

Ajo që në thelb ka nevojë të sqarohet, siç e parashtroi edhe zonja Hysi, kur diskutuam për projektligjin në parim, është se regjistrimi i ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike nuk është i detyrueshëm. Është një mundësi për të gjithë operatorët e shërbimeve...

Ulsi Manja – Pra, jemi te neni 23 tani, te regjistrimi.

Klotilda Bushka – Po, jemi te neni që sapo miratuam, te neni 22.

Dua ta shpjegoj, sepse e miratuam, por vetëm për ta ripërforcuar edhe një herë. Nuk bëhet fjalë për regjistrim të detyruar, por për një mundësi që u ofrohet operatorëve të shërbimeve të publikimeve elektronike. Regjistrimi në këtë regjistër është mundësia për të përfituar nga incentivat fiskale në të ardhmen, që mund të parashikohet me ligje të posaçme, saç është, për shembull, propozimi i një grupi deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për uljen e TVSH-së në shërbimet mediatike (nëse e kam të saktë termin) prej 6%. Është ende në proces, por përfitimi do të jetë i kushtëzuar me regjistrimin në këtë regjistër. Nuk është detyrim, por është një mundësi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Kalojmë te neni 23.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Për nenin që sapo votuam keni koment apo për nenin 23?

Gentian Sala – Nuk e kam këtë për të ndryshuar gjë, por shoh një problem për subjektet, të cilat nuk regjistrohen (është zgjedhja e tyre), nuk japin informacion as për administratorin, as për adresën, nuk japin asnjë lloj informacioni, por thjesht janë portale. Me këto subjekte shoh se nuk ndodh asnjë gjë, nuk futen në fushën e veprimtarisë. Mund të vazhdojnë të financohen nga të duan dhe nuk kanë asnjë ndalesë. Pra, subjekti Gentian Salaj.al nuk jep as emrin e pronarit, as administratorin... Gjobën kujt do t'ia vëmë, në fund të fundit? E zëmë se dolëm te gjoba. Kujt do t'i vihet?

Ulsi Manja – Po, zonja Bushka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Vasilika.

Vasilika Hysi – Zoti Salaj, një nga shqetësimet e ngritura nga ekspertët e OSBE-së dhe të Këshillit të Europës ishte rregullimi pronësisë, pikërisht kjo që thoni ju, dhe transparenca e financimit të portaleve, për të shmangur paratë e botës së krimit, financimin nga grupet terroriste e të tjerë.

Si bëhet kjo gjë sot nga AMA? Si ju arrini...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, për medien.

A e keni rregullimin për të kontrolluar pronësinë? Sepse tek treguesit e Këshillit të Europës për medien në demokraci, i jepet shumë rëndësi transparencës së financimeve, pronësisë, barazisë që duhet të kenë mediet në përfitimin e fondeve e të tjera.

Gentian Sala – Për sa kohë institucionet financiare nuk marrin një rast të vetëm si shembull, të them të drejtën, unë i marr si çështje dytësore. Kam parasysh këtu edhe kur thonë, për shembull, se institucionet publike bëjnë reklamë, se nuk kontrollohet reklama që bëhet në institucionet publike nëpër televizione. Harxhohen miliona euro nga institucionet ndërkombëtare për të bërë studim dhe nuk ka një të dhënë të vetme që kaq milionë euro bëhen për këtë. Pra, ata flasin gjithmonë në koncept, në parim, dhe gjithë presioni u drejtohet institucioneve shqiptare, që të zbulojnë armikun.

Unë nuk di një rast të vetëm që të jetë shtruar me emër dhe mbiemër dhe të fillojë një procedurë. Po, ne e kemi futur në procedurat tona, që, në momentin kur bëhet rilicencimi i subjektit, ne çojmë shkresë edhe te pastrimi i parave, por mos prisni që AMA të bëhet edhe pastrues parash, edhe gjykatë, edhe të bëjë filtrim të të ardhurave. Përveç kësaj, kemi bërë edhe këtë tjetër, që të gjitha bilanci e kompanive të jenë *online* te faqja e AMA-s. Është buletini i AMA-s, që është super i detajuar. Kështu që, këto institucionet ndërkombëtare i marr më shumë si...

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Gjithë qëllimi i debatit është ta bëjmë këtë medie të identifikueshme. Ne nuk kemi asnjë synim tjetër. Ne kemi thënë që kushdo në Republikën e Shqipërisë është i lirë të merret me ato që lejohen nga legjislacioni, por të dihet kush është.

Tani, te neni 33 themi: “Ka të drejtë të aplikojë”, por ne biem ndesh me gjithë qëllimin. Është i detyruar, jo ka të drejtë. Duhet mbështetur edhe ky shqetësim i AMA-s. Thelbi është që ti lirinë tënde do ta shprehësh me këto rregulla. Këtë duhet ta dijë çdo qytetar. Institucionet po e po,

por edhe çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë duhet ta dijë se me kë ka të bëjë. Pastaj, është tjetër çështje ajo që shpreh, ajo që publikon dhe ajo që thua. Po të jemi kontradiktorë, nuk do të bëjmë asnjë gjë.

Ulsi Manja – Kam edhe unë një pyetje, zoti Salaj (e kam edhe për relatorët, në fakt): si lidhet neni 33/1 me nenin 33/2? Sepse në pikën 1 të nenit 33/1 thuhet: “Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik duhet të bëjë lehtësisht të aksesueshëm, në mënyrë direkte dhe të përhershme për publikun e gjerë, të paktën informacionin e mëposhtëm:

a. emrin e ofruesit të shërbimit;

b. vendosjen e zyrës qendrore ose qëndrimin e ofruesit të shërbimit, adresën e tij elektronike ose atë të faqes së internetit;

c. organin kompetent të ofruesit të shërbimit.”

Në nenin 33/2 thuhet: “Ky regjistrim nuk është parakusht për të ofruar shërbimin.”

Si qëndrojnë këto dy paragrafë njëri me tjetrin?

Gentian Sala – E lëmë AMA-n, e lëmë institucionin. Kemi problemin e një qytetari që preket nga portali. Ai nuk shkon dot në gjykatë, sepse nuk as emër, as adresë. Personalisht, kam pasur punonjës të AMA-s, që kanë pasur probleme. Nuk ankohesh dot. E lëmë institucionin, i lëmë gjrobat e të gjitha. Kujt do t’ia vësh gjobën? Prandaj po them se është lënë si vagull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Problemi është ta rregullojmë, sepse, në fakt, një nga qëllimet e projektligjit ky është. Si do ta garantosh ti të drejtën e qytetarit për t’u ankuar te Këshilli i Ankesave të AMA-s? Pra, ne i themi një qytetari: “Të japim të drejtën të ankohesh në Këshillin e Ankesave për një publikim elektronik, por kur të shkosh aty AMA do të kthejë përgjigjen që nuk e dimë se kush është pronari i këtij portali që e ka bërë këtë shkrim”. Pra, në fund nuk kemi garantuar asgjë, as të drejtën e ankesës, as të drejtë aksesit në gjykatë të qytetarit apo ofruesit të shërbimit të publikimeve elektronike në një fazë të dytë.

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka - Siç e thashë edhe në fillim, draftet e propozuara nga Këshilli i Ministrave vënë në balancë të drejtat e qytetarëve, në respekt të dinjitetit dhe të jetës së tyre private, me të drejtën e medias së lirë dhe lirinë e shprehjes. Balanca, sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare, kur bëhet fjalë për shërbimet e publikimit elektronik, nuk i detyron dot subjektet

përkatëse të regjistrohen dhe pastaj të japin shërbim. Pra, ky është standard. Në këtë standard, me të drejtë, Këshilli i Ministrave dhe nismëtarët nuk kanë ndërhyrë. Prandaj është lënë si një mundësi.

Fusha e zbatimit të ligjit do të jetë për ata që regjistrohen. Ata që nuk regjistrohen dhe kanë kryer veprimtari që cenojnë të drejtat e njeriut, janë në situatën ku organet e drejtësisë duhet të marrin masa. Pra, do të penalizohen sipas kallëzimeve të mundshme.

Ne, me të gjitha rekomandimet e ndërkombëtarëve, jemi harmonizuar që ta lëmë si një mundësi regjistrimin dhe jo si një detyrim. Dakord?

Ulsi Manja – Pra, sipas kësaj logjike, ligji rregullon fushën e veprimtarisë të atyre që janë të ligjshëm në treg, pra ata që janë të regjistruar, ndërsa ata që janë të paregjistruar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe një pyetje, zoti Hyseni.

Zoti Salaj, a kemi sot instrument ligjor mesa AMA-s dhe AKEP-it, që këto subjekte, që nuk janë të regjistruara ose, le të themi, nuk janë të identifikueshme, të identifikohen? Nuk ka.

Gentian Salaj- Edhe një herë, unë nuk po them që këto subjekte të regjistrohen, kjo le të rrijë e hapur, por minimalisht të kenë adresë. Pra, është parim. Nuk mundet një subjekt të flasë për një person fizik dhe ti të mos dish ku të ankohesh.

Ulsi Manja – Pra, ju kërkoni adresën, jo detyrimisht regjistrimin.

Gentian Sala - E lëmë fare AMA-n, e lëmë regjistrin. Nuk ka punë me regjistrin, por të ketë adresë.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Kam frikë se nga kujdesi i tepërt për të mos cenuar lirinë e fjalës, ne po harrojmë që po bëjmë një ligj rregullues, jo ndalues. Këtu ideja është që askush nuk duhet të ketë barrierë licencimi apo barriera të tjera për të ushtruar këtë veprimtari, por të jetë i lirë për ta ushtruar. Pasi e ka filluar aktivitetin, formulimi ka qenë “një personi, i cili ofron shërbime i kërkohet vetëm të vetëdeklarojë”. Këtu mund të ruajmë termin “të vetëdeklarojë”. Pra, nëpërmjet një formulari ...

Të dhënat janë të detyrueshme për këdo. Nuk ka asnjë shkelje për të deklaruar të dhënat. Unë sfidoj këdo që të më thotë cila konventë ndalon deklarimin e të dhënave të dikujt që kërkon të merret me një ...

Edhe për të dhënat personale të individëve ka ligj që rregullon kufirin deri ku ato deklarohen. Prandaj, të mos i ngatërrojmë, sepse nuk po bëjmë asgjë. Ne po bëjmë të njëjtën gjë

që bëjnë për njerëzit e ndershëm, të cilët paguanin energjinë elektrike. Çmimi u rrit dhe ata paguanin më shumë, ndërkohë që abuzuesit, që në atë kohë ishin 50%, nuk paguanin, sepse nuk kishin kontratë. Të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Në variantin e Këshillit të Ministrave dhe të nismëtarëve ky nen ka ardhur me mundësinë për regjistrim. Unë mendoj se është i drejtë për sa kohë shpjegova më parë çështjen e të drejtave që ka media e lirë dhe lirinë e shprehjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Regjistrimi në regjistër si një mundësi është një mekanizëm që njihet në të gjitha vendet ku ne jemi referuar për këtë draft-ligj. Unë mendoj që të mos ndryshohet, por të lihet siç është paraqitur nga qeveria. Në qoftë se kolegët kanë propozime, unë mendoj t'i lëmë si shënime për rekomandim për komisionin përgjegjës. Personalisht, por besoj se jemi në një mendje me relatoren, zonjën Hysi, mendoj se duhet lënë siç ka ardhur nga Këshilli i Ministrave dhe siç rekomandohet nga OSBE-ja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Kryetar, mund të them diçka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti kryetar!

Kryetari i AMA-s dhe kolegët pyetën se ku e gjejmë ne të drejtën që nuk e vëmë si kush licencimin e të tjera. Treguesi 15 i Këshillit të Europës për mediet në demokraci thekson se shtypi dhe mediat në internet nuk duhet të kenë nevojë të pajisen me licencë nga autoritetet, përveç regjistrimit në listën e bizneseve dhe në drejtorinë e tatimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbarojë mendimin! Ne flasim për dy gjëra të ndryshme.

E para, unë pajtohem me shqetësimin që ngriti zoti Sala. Nga 700 portale, thotë studimi i fundit i Këshillit Shqiptar të Mediave, vetëm 45 janë të regjistruar. Ne duhet të ndajmë regjistrin e ofruesve elektronikë dhe regjistrin në listën e bizneseve në drejtorinë e tatimeve.

E dyta, ka një informalitet të madh. Studimet e organizatave të mediave thonë që ka informalitet, por këto 2 vjetët e fundit ky informalitet ka ardhur duke rënë. Ne do të japim një rekomandim, jemi ligjvënës dhe kemi instrumentet e kontrollit parlamentar, që QKB-ja dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të fillojë një fushatë sensibilizimi, jo ndëshkimi dhe të inkurajojë median të regjistrohet dhe vetërregullohet.

Gjatë fjalës sime e thashë disa herë që në këtë ligj hapësira për t'u vetërregulluar ekziston. Në raportin tonë ne do ta nxisim median dhe do ta vëmë theksin te vetërregullimi, por nuk mund të rregullojmë çdo gjë, sepse media është e lirë.

Ulsi Manja – Zonja Hysi, unë tani e kam të qartë që regjistri i AMA-s është tjetër, kurse për sa i përket procesit të licencimit, siç thotë kolegu Hyseni, patjetër që ka autoritete të tjera që duhet ta ndjekin këtë problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që do të jetë në rekomandim.

Nëse më thoni që sipas një studimi sot në treg janë 700 portale nga të cilat vetëm 45 apo 49 janë të regjistruar, shkalla e informalitetit nuk ka nevojë, dihet: 700 me 49.

Po, zoti Sala, një fjalë të fundit.

Gentian Sala – I nderuar kryetar, dhe e mbylla, nuk po them as të regjistrohen, as të vetëdeklarohen për punonjës, madje nuk po them asnjë çështje që ka lidhje me procedurat administrative të shtetit, të institucioneve e të tjera, por po them: emrin, mbiemrin, adresën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai le të zgjedhë të mos regjistrohet kurrë.

Ulsi Manja – Dakord, por këtë e garanton neni 22 në pikën 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Emrin e ofruesit të shërbimit; e detyron.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është 33/2-shi, që ka të bëjë me regjistrimin e ofruesit të shërbimit, që e lë me mundësi. Ndërsa 33/1-shi e ka detyrimin e OSHPE-së për ta dhënë edhe emrin e ofruesit të shërbimit, edhe vendndodhjen e zyrës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e detyron për regjistrim, moj Elena, por jo për të hapur...

Klotilda Bushka – OSHPE-ja është person juridik dhe fizik i regjistruar, jo një person që nuk e njeh ligji. Ju lutem, ta ndajmë këtu! Pra, një OSHPE, që ka të drejtën të shkojë t'i publikojë të dhënat e veta te ky regjistrë, duhet të jetë një ofrues i Shërbimit të Publikimeve Elektronike, i cili është i regjistruar si person fizik ose juridik në tatime, në QKB. Ndërkohë, një person që nuk

ekziston fare, as si person juridik, as si person fizik, është i paligjshëm. Pra, nuk mund ta japë aktivitetin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të vijë një i paligjshëm te ju. Nuk ka kuptim. Prandaj ju themi: për këto çështje duhet që organet e tjera të ligjit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, por si mund të regjistrojë AMA një...

Ju lutem, zoti Hyseni, më kuptoni pak!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si mundet AMA të pranojë në regjister një individ, i cili thotë: kam një portal, kur ai portal...

Ulsi Manja – Është i paligjshëm.

Klotilda Bushka – ... nuk është aktivitet që ushtrohet nga një person fizik apo nga një person juridik. Këtu flasim për paligjshmëri, e cila është çështje që duhet ndjekur nga organet përkatëse të tatimeve, në qoftë se duhet të jetë subjekt tatimor, sepse bën aktivitet ekonomik; në qoftë se bën aktivitet jofitimprurës, ka, gjithashtu, detyrime regjistrimi, madje, në qoftë se është aktivitet i paligjshëm, shkon edhe në kufijtë e veprës penale. Mendoj se formulimi është menduar shumë mirë.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Kam një propozim konkret. Meqenëse shqetësimi i AMA-s, imi dhe i disa kolegëve është identifikimi i subjekteve që funksionojnë dhe ju prezumoni që ata janë të regjistruar në tatime, në regjistra të tjerë të shtetit, shumë mirë, atëherë bëjmë këtë: detyrojmë institucionet e tjera (nuk kemi punë fare me median), si institucionet e tatimeve apo të regjistrimit të subjekteve që ta njoftojnë AMA-n për çdo regjistrim dhe AMA hap regjistrin. E ndërtojmë kështu? Nuk kemi punë me median, as me vetëdeklarimin, as me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Përveç kësaj, shtojmë...

Alket Hyseni – Dhe, nëse ka të paregjistruar, ata t'i konsiderojnë të paligjshëm dhe të shkojnë drejt mbylljes. Se çfarë kuptimi ka?! Pse t'i penalizojmë të ndershmit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flas për regjistrin në tatime apo në Qendrën e Biznesit.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Propozimi i kolegut Hyseni është racional. Në qoftë se flasim për shkallë informaliteti, ju lutem tani, organet tatimore të kryejnë punën e tyre, more, se këtu kemi një ligj tjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çdo gjë e paligjshme ka instrumentet dhe mekanizmat e veta të mbikëqyrjes dhe të kontrollit. Tani nuk po bëjmë një ligj që t'i japim AMA-s në dorë edhe instrumente për të luftuar paligjshmërinë në treg, sepse ka agjenci të tjera publike dhe shtetërore që e luftojnë paligjshmërinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Paligjshmëria fillon në momentin kur portalet nuk regjistrohen. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord jam.

Spartak Braho – E dyta, Alket, më ndiq pak, ne jemi shtet. Këto portale fillojnë e merren me veprimtari antikombëtare.

Ulsi Manja – E thotë ligji këtë.

Spartak Braho – Po pra, antikombëtare, antiligjore...

Do ta përmbledh me një gjë. Ne i turremi AMA-s. Në fakt, përgjegjësinë e kanë... Në qoftë se Shërbimi Informativ do informacion, policia do informacion se kush janë këta, ku do t'i gjejnë? Do të përgjigjet ai?

Ulsi Manja – Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Atëherë, është detyrimi i tij. Të mos ngatërrojmë...

Ulsi Manja – Atëherë, është propozimi i kolegut Hyseni.

Spartak Braho – ...fjalën e lirë të tyre. Fjala e lirë është të thotë çfarë të dojë brenda ligjit, jo për t'u regjistruar.

Ulsi Manja – Atëherë, biem dakord që të shtohet propozimi i kolegut Hyseni që vendos detyrimin e agjencive të tjera për të informuar AMA-n lidhur me procesin e regjistrimit për ofruesit e shërbimeve të publikeve elektronike?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të shtohet në tekstin e nenit...

Alket Hyseni – Në bazë të të cilit AMA mban një regjistër.

Ulsi Manja – Pra, debati për nenin 22 konsiderohet shterues, me sugjerimet e relatores dhe me propozimin e kolegut Hyseni.

Kalojmë te neni 23, për të cilin është e njëjta logjikë. Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 23.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sara Xhumbari – Më falni, nëse mundem, kam një koment teknik!

Për qëllim harmonizimin me gjithçka që është parashtruar deri tani, mendoj se te pika 3 duhen shtuar fjalët “ose me kërkesë të vetë ofruesit të shërbimit”, sepse...

Ulsi Manja – Pra, pas fjalëve “Pas mbarimit të afatit të parashikuar në licencën apo në autorizimin e lëshuar, AMA fshin nga regjistri ofruesin e shërbimit” të vijohet me fjalët “ose me kërkesë”.

Sara Xhumbari – Ose para AMA.

Alket Hyseni – “Dhe njofton institucionet e tjera”, se çfarë kuptimi ka?! Regjistri i AMA-s është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Dakord, zoti Hyseni!

Ulsi Manja – Biem dakord me sugjerimin për pikën 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Ta riformuloj pak?

Ulsi Manja – E ka kërkuar fjalën për procedurë zoti Braho.

Klotilda Bushka – Ta riformulojmë: “Pas mbarimit të afatit të parashikuar në licencën apo autorizimin e lëshuar, AMA kryesisht ose me kërkesë nga subjekti i interesuar fshin nga regjistri ofruesin e shërbimeve të medias dhe njofton autoritetet përgjegjëse, të cilat e kanë informuar AMA-n në lidhje me këtë subjekt”. Të jetë pak a shumë kjo, por do ta bëjmë si rekomandim në opinion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Dakord.

Për procedurë, ta hedhim në votim nenin 23, zoti Braho, dhe pastaj do t’jua jap fjalën.

Kush është dakord me nenin 23 me sugjerimin e bërë për pikën 3? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fjalën e ka zoti Braho për procedurë.

(Deputeti Braho flet pa mikrofon.)

Spartak Braho – ...Komisioni i Ligjeve është komision përgjegjës për çdo gjë, edhe për të mbrojtur shkeljet kushtetuese, edhe shkeljet ligjore, ndërsa komisionet e tjera janë në ndihmë të Komisionit të Ligjeve.

Ulsi Manja – Zoti Braho...

Spartak Braho – Nuk na nderon që të shkojë projekti... Këto që diskuton Komisioni i Ligjeve, komisionet e tjera nuk i kuptojnë fare.

(Ilaritet në sallë)

Ulsi Manja – Zoti Braho, shumë faleminderit!

Në fakt, nëse do t'i referohemi procedurës parlamentare, pothuajse për 100% të projektligjeve që vijnë në Kuvendin e Shqipërisë Komisioni i Ligjeve bën oponencën ligjore dhe, në masën dërrmuese, 95% të këtyre projektligjeve jemi komision përgjegjës. Pse? Sepse kemi një sferë të gjerë të veprimtarisë.

Pastaj, mos harroni se kemi tri nënkomisione, pra jemi komision përgjegjës për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për administratën publike dhe për pushtetin vendor. Por, absolutisht, edhe shtatë komisionet e tjera të përhershme, veç komisionit tonë, kanë sferën e veprimtarisë dhe rëndësinë e tyre në punën e Kuvendit të Shqipërisë. Nuk e themi këtë për t'iu shmangur përgjegjësisë, absolutisht, por përputhshmëria e çdo ligji me Kushtetutën dhe me korpusin e ligjeve në fuqi është detyrë e këtij komisioni të Kuvendit të Shqipërisë!

Kalojmë te neni 24.

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Neni 24 shton një pikë 6/1 në nenin 42 të projektligjit. Është shumë e rëndësishme, sepse këtu parashikohet të përfshihen të gjitha format e komunikimeve: “me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive dhe publikimet elektronike për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingot televizive janë të ndaluara”. Dakord? Ky është formulimi.

Ulsi Manja – Biem dakord me nenin 24? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 25. Ka sugjerime, apo të kalojmë në votim?

Klotilda Bushka – Jo, kam vetëm një sqarim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Jemi te neni 25 “Procedurat për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave”.

Klotilda Bushka – Këtu kemi të bëjmë me ankesat që kanë subjektet ndaj operatorëve të shërbimeve të publikimeve *online* në lidhje me publikimet e kryera. Është trajtuar e gjithë procedura se si veprohet në këto raste, duke u dhënë të drejtë edhe operatorëve të kenë mundësinë e përgjigjes, edhe subjekteve që pretendojnë se kanë një shkelje nga publikimet, të mbrojnë të drejtat para se t’i drejtohen gjykatës.

Ulsi Manja – Kalojmë te neni 25.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 26.

Nuk ka sugjerime te neni 26, janë çështje të shkurtra të teknikës legjislativ, që janë reflektuar.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27.

A jeni dakord me nenin 27?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Neni 53 i ligjit aktual parashikon të drejtën e përgjigjes që ka çdo person, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit është prekur nga publikimi i fakteve dhe i informacioneve jo të sakta, pra është në një transmetim dhe është shtuar edhe “nga një publikim elektronik”. Tani, ne kemi shtuar 53/1 si nen, i cili detajon të gjithë procedurën se çfarë bën AMA kur vjen një ankesë e tillë, cilat janë të drejtat e operatorit të shërbimit të publikimit elektronik, cilat janë të drejtat e subjekteve të interesuara, afatet, përfshi dhe të drejtën e ankimit në gjykatë.

Elena Xhina – E kam për teknikë legjislative. Te pika 3 ku thuhet “për informacionet që pretendohen jo të sakta” të shtojmë “dhe/ose të pavërteta”, meqë u referohemi të dyja rasteve.

Gentian Sala – Në linjë me ndryshimet e bëra në nenin 27, përkatësisht me gjykatën kompetente, që mund të shqyrtojë ankimin ndaj vendimit, duhet bërë edhe ndryshimi i nenit 53 të ligjit ekzistues, që e parashikon pika 15: “Vendimi i AMA-s mund të kundërshtohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”, pra për të dalluar juridiksionin e përgjithshëm civil të gjykatës nga juridiksioni administrativ, që duhet të shqyrtojë ankesat në këto raste.

Klotilda Bushka – Zoti kryetar, a mundem?

Ulsi Manja – Po.

Klotilda Bushka – Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë ka të drejtë, sepse për sa kohë që në të gjithë formulimin që bëjmë në nenin 53/1 i referohemi të drejtës së ankimit në Gjykatës Administrative (se gjykatat e juridiksionit administrativ, për sa kohë ankohet ndaj një akti administrativ siç është AMA), duhet unifikuar e njëjta gjë edhe me parashikimin që ka neni 53 i ligjit, i cili duke qenë se është një ligj i miratuar para se të krijoheshin gjykatat administrative, i është referuar Gjykatës Civile. Por ndoshta nga praktika gjyqësore gjykatat e rregullojnë vetë juridiksionin në praktikë, duke ia referuar çështjet gjykatave administrative. Në këtë moment është i drejtë sugjerimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe unë mendoj të shtojmë një pikë, ku ndryshojmë edhe nenin 53 ku nga gjykatë civile juridiksionin ia lëmë gjykatave administrative.

Ulsi Manja – Po, zoti Beja.

Besmir Beja – Vetëm në këtë pikë përcaktohet shprehimisht që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kurse në vende të tjera në ligji i referohet gjykatës, kështu që edhe mund të shkojë për shkak të ligjeve të tjera, por këtu duhet bërë ndërhyrja e posaçme për të bërë këtë lloj rregullimi.

(Mungesë incizimi)

Jetmir Braha – Unë jam Jetmir Braha nga AKEP-i.

Të pika 1, a/2 e nenit 28 citohet shprehimisht: “...për të vendosur nëpërmjet AKEP-it një njoftim të karakterizuar teknikisht si *pop up*”.

Jemi te ligji i medieve dhe praktikisht po flasim për vendimmarrjen që po merr AMA ndaj një subjekti të medieve elektronike. Duke qenë se është pjesë e vendimmarrjes së AMA-s këtu nuk duhet të përfshihet AKEP-i, sepse do të binim ndesh me nenin 2 të ligjit nr. 9918, i cili e ndalon AKEP-in të shqyrtojë përmbajtjet e komunikimeve elektronike. Pra, ne propozojmë të hiqet fjala “nëpërmjet AKEP-it.”

Ulsi Manja – Po, zonjë, e keni për pikën 5?

Sara Xhumbari – Jo, kam një sugjerim për riformulimin. Në vijim të asaj që shpreh Jetmiri është thënë që te neni 53 “masat për shkeljen” Bordi dhe Këshilli i Ankesave vendosin detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias për të publikuar formulimin e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes të parashikuar në nenin 53/1; 2/i për të vendosur nëpërmjet AKEP-it njoftimin teknik *pop up*. Sugjerimi mund të ishte që të dyja të harmonizohen në një formulim dhe të thuhet “për të publikuar formulën e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes së parashikuar në nenin 53/1 të këtij

ligji shoqëruar me një njoftim të dukshëm *pop up*”, siç përkufizohet në gjuhën teknike, sepse janë në funksion të njëra-tjetrës, nuk janë masa njëra pas tjetrës, domethënë është formulimi i korrigjimit i shoqëruar me një njoftim të dallueshëm, që tërheq vëmendjen.

Ulsi Manja – Po, faleminderit!

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – I kuptoj shqetësimet e AKEP-it, por mendoj se nuk mund t’i bashkojmë pikat a/i dhe 2/i, sepse bëhet fjalë për dy situata të ndryshme, mund të jenë të ngjashme në raste të caktuara, por përgjithësisht janë të ndryshme. Formula e korrigjimit nuk bëhet vetëm nëpërmjet AKEP-it, por edhe në portalin e OSHPE-së, kështu që nuk mund ta bashkojnë me detyrimin që ka AKEP-i. Sa i takon pikës a/2/i për të vendosur nëpërmjet AKEP-it një njoftim të karakterizuar, mund të thoni që fjalën “për të vendosur” ta riformulojmë në një mënyrë të përshtatshme, që të mos jetë si urdhër, por ama duhet të qëndrojnë të ndara. Pra, “vendos për të kërkuar në AKEP”, se kjo është ideja, AMA vendos t’i kërkojë AKEP-it të kryejë një veprim të caktuar, por është AKEP-i që ekzekuton.

Ulsi Manja – Ideja është që AKEP-i është njësi zbatuese, pra mund të gjendet formulimi për pikën 2/i, se në pamje të parë duket sikur AMA urdhëron AKEP-in, ose sikur merr rolin e AKEP-it. Këtu bëhet fjalë që AKEP-i si njësi zbatuese zbaton një vendim që është marrë nga AMA.

U lutem kolegëve, ta mbarojë relatorja nenin 28!

Klotilda Bushka – Neni 28, i cili ndryshon përmbajtjen e nenit 132 të ligjit aktual ka të bëjë me masat për shkelje. Në versionin e paraqitur ka riformulime të dakordësuara sipas propozimeve të ekspertëve të OSBE-së, konkretisht, propozim në lidhje me të drejtën e AMA-s për të vendosur gjoba, për të vendosur pezullim të përkohshëm të licencës dhe autorizimit, për të vendosur uljen e kohëzgjatjes së ligjshmërisë së licencës dhe autorizimit, si dhe për të vendosur heqje të licencës dhe autorizimit.

Ndërkohë propozimet e grupit të punës kanë të bëjnë me afatet për urdhërimin e heqjes së përmbajtjeve të caktuara, që janë të ndaluara të qëndrojnë në portale. Ne kemi sugjeruar që ky afat të mos jetë më shumë se 60 minuta, pra bëhet fjalë për ato publikime me përmbajtje që cenojnë të drejtat e fëmijëve, sepse bëjnë fjalë për pornografinë e fëmijëve apo për vepra të tjera të turpshme, për ato publikime që cenojnë sigurinë kombëtare, që nxisin gjuhën e urrejtjes, të cilat duhet të hiqen menjëherë dhe nëse nuk hiqen me vullnet nga vetë subjekti është AMA që i kërkon AKEP-

it të mbyllë faqen, jo vetëm sipas parashikimeve të këtij ligji, por edhe sipas kuadrit ligjor ekzistues në fuqi. Ne kemi kërkuar të bëhet 60, edhe pse 60 minuta janë shumë.

Ulsi Manja – Nëse bëhet fjalë për pornografi me fëmijë, për inkurajim të akteve terroriste dhe shkelje të sigurisë kombëtare, 60 minuta i bie 1 orë dhe lajmi arrin në 7 kontinente, se kjo është shpejtësia e përhapjes, pra aq sa zgjat shpejtësia e marrjes së vendimit dhe e ekzekutimit.

Klotikda Bushka – Duhet të vëmë një afat “menjëherë, por jo më shumë se”, se po e lamë vetëm “menjëherë” ai do të thotë “unë tani e mora vesh”.

Ulsi Manja – Në pikën 5 të bëhet “menjëherë, por jo më shumë se kaq”.

Po, përfaqësuesi i AKEP-it.

Jetmir Braha – Unë vazhdoj të insistoj se ky nen ka të bëjë me detyrimin që do të kenë ofruesit e shërbimit të medieve elektronike. Ndërkohë AKEP-i do të vendosë detyrime mbi ISPT-të, që nuk janë e pjesë e këtij ligji, por të ligjit nr. 9918 dhe rregullohen në atë ligj. Kjo është pika 1/a/2, domethënë për të vendosur nëpërmjet AKEP-it një njoftim të karakterizuar teknikisht si *pop up*. Ne kërkuam të hiqnim fjalën “nëpërmjet AKEP-it”, sepse nuk i njeh mjetet elektronike dhe nuk mund të shqyrtojë përmbajtjet e komunikimeve elektronike të tyre. Është neni 2 i ligjit 9918...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kjo nuk është shprehur qartë këtu.

Klotilda Bushka – Ka një keqkuptim. Nuk do të shihni përmbajtjen, sepse këtë do ta shohë AMA. AMA do t’i bëjë një kërkesë AKEP-it, që ju duhet të vendoni një *pop up*.

Ulsi Manja – Hiqet fjala “për të vendosur”, se e keni në paragrafin më lart. Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, në përputhje me procedurat dhe parashikimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij, pas marrjes së mendimeve të organeve përgjegjëse, nëse parashikohen, AMA vendos nëpërmjet AKEP-it një njoftim të karakterizuar. E ka sipër fjalën “vendos AMA”, ta heqim “për të vendosur” tek pika 2/i.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, e ka zgjidhur neni 28 shumë qartë. Po të lexoni paragrafin e parë të këtij neni flet për vendimmarrje të AMA-s, pra AMA vendos dhe tek pika 2/i, nëse hiqet fjala “për të vendosur” dhe të lihet “nëpërmjet AKEP-it”, del i qartë qëllimi.

Alket Hyseni – AKEP-i do të dojë një akt konkret, në kuptimin e një ligji urdhërues për të vepruar, dhe ne themi “vendos urdhërimin e AKEP-it për njoftim të karakterizuar teknikisht *pop up*”.

Jetmir Braha – Po flasim për detyrimin e medieve elektronike.

Alket Hyesni – Një minutë të mbaroj sqarimin!

Në bazë të këtij ligji AKEP-i e ka marrë detyrimin të veprojë sa herë i kërkohet dhe nuk merret këtu emri i organit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga kush je i pavarur ti? Nga ligji? Nuk je i pavarur, je aty për të bërë punën, ti je i pavarur të ushtrosh kompetencat i pandikuar nga ekzekutivi, apo nga organe të influencuara, por jo nga ligji, apo nga një organ, që e kemi ngritur ne dhe që është mbi palët. Ne këtë po bëjmë. Ky është një organ teknik që ka shkelur ligjin dhe bllokohet. Bëj njoftimin *pop up*.

Jetmir Braha – Për pjesën e bllokimit jemi dakord.

Ulsi Manja – Po mbytemi me një pikë ujë. Ju, lutem të mos flasim të gjithë përnjëherë!

A ka mundësi të na thuash çfarë të shqetëson ty si AKEP?

Jetmir Braha – Me këtë nen nuk mund të detyroj një portal, po them kot “Jeta osh qejf” që të nxjerrë këtë *pop up* në faqen e tij, se nuk është kompetencë e AKEP-it.

Ulsi Manja – Po nuk e ke ti atë detyrim.

Jetmir Braha – Kështu është shkruar këtu.

Ulsi Manja – Lërë se çfarë është shkruar, ne po diskutojmë si ta rregullojmë. Nuk je ti autoriteti që do të marrësh vendim për përmbajtjen e materialit që ka publikuar ai portal, por do të jesh njësi zbatuese teknike e një vendimi që merr AMA, sepse ti ke çelësin.

Klotilda Bushka – E keni lexuar gabim nenin dhe po na çoni edhe ne në keqkuptime. Pika 1 e nenit 132 që mbaron me fjalët “AMA vendos:” thotë: a) detyrimin e ofruesit të shërbimit të medies. Pikat i dhe 2/i janë për ofruesin e shërbimit të medies, nuk janë për AKEP-in. Ju lutem, kuptojeni! Pra, ofruesi i shërbimit të medies, me vendim të AMA-s, ose detyrohet të publikojë formulën e korrigjimit, ose nëpërmjet AKEP-it sjell një njoftim të karakterizuar si *pop up*.

Ulsi Manja – Është e rregulluar nëse bëjmë saktësimin te pika 2/i.

Kush është dakord me nenin 28 me saktësimin?

Po.

Gentian Sala – Te pika 6 e nenit 28 thuhet: “...kundër vendimeve të bllokimit të aksesit në internet të subjektit, etj AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin brenda 5 ditëve”. Të mos harrojmë se AMA në dallim nga AKEP-i nuk është një institucion që bordin e ka me kohë të plotë, mund të jenë pedagogë, mund të jenë publicistë. Të mos harrojmë gjithashtu se brenda 48 orëve

ne duhet t'u çojmë dosjet anëtarëve të bordit dhe institucioni vihet në presion të jashtëzakonshëm dhe, mbase e teproj po ta them, por me siguri kjo pikë do të shkelet. Nga praktika e dimë që nuk e kap dot afatin me procedurë normale e jo më në rastet kur duhet të vijë dosja, të bëhet relacioni dhe të njoftohet anëtari i bordit, i cili nuk është me kohë të plotë aty.

Klotilda Bushka – Po e bëjmë me 5 ditë pune.

Gentian Sala – Nuk bëhet, se e dimë nga praktika, mund ta vëmë, por nuk e kap dot. Të mos harrojmë se kemi pedagogë që japin leksione jashtë.

Klotilda Bushka – Zoti Sala, të flasim për ato raste kur pretendohet cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut, siguria, çështja e gjuhës së urrejtjes. Mund ta bëjmë 5 ditë pune.

Ulsi Manja - Është e ezauruar po ta lëmë ditë kalendarike.

Gentian Sala – Është shumë pak.

Klotilda Bushka – Po mirë 7 atëherë, se 10 janë shumë.

Gentian Sala – Procedura ka filluar, gjobën e ka vënë.

Ulsi Manja – Po sikur ta bëjmë “...dhe shpall vendimin jo më vonë se 7 ditë”, se duhet vënë një tavan. Të mos ndalojmë në një pikë që është tërësisht teknike!

.

Ulsi Manja – Jo më vonë se 7 ditë shpallet vendimi.

Zonja Hysi, të mos ndalojmë në një pikë që është tërësisht teknike! **Klotilda Bushka** – 7 ditë pune

Ulsi Manja - 7 ditë pune është e mjaftueshme. Merrni masat të mbledhet AMA, se nëse profesorët janë në Shqipëri nuk kanë arsye të mos vijnë në mbledhje.

Kush është dakord me nenin 28, me sugjerimet që u bënë?

Për pikën 1, germa 2/i dhe për pikën 5 “menjëherë, por jo më vonë se 60 ditë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Po, është sipas parashikimeve të nenit.

Ulsi Manja – A ka ndonjë merak tjetër për nenin 28?

Sara Xhumbari – Në pikën 9 parashikohet që KA nuk ka detyrim të parapaguajë tarifën e shërbimit përmbartimor. Këshilli i ankesave nuk ka personalitet të veçantë ligjor, pra nuk ka detyrim të parapaguaj tarifën për shërbimin përmbartimor, ai vepron në emër të AMA-s.

Ulsi Manja – Është rregullim i teknikës legislative, të vihet ai që ka personalitetin juridik, pra Autoriteti i Medieve Shqiptare.

Gentian Sala – Problemi është që Këshilli i Ankesave është te pika 8. Këshilli i Ankesave me vendosjen e gjobës shkon në gjykatë, ecën me procedurë si një institucion tjetër paralel me bordin e AMA-s. Për mendimin tim mos e lëvizni, lëreni ligjin siç është, se është shumë mirë, procedura ka filluar, gjoba është vënë, nuk ndryshon asgjë, madje gazetarëve u jep kohë, nuk po flas për këta të bllokimit.

Ulsi Manja – Detyrimet dhe përgjegjësitë lindin për atë që ka personalitetin juridik.

Klotilda Bushka – Duke qenë se për disa nivele vendimmarrëse të Këshillit të Ankesave bëhet ankim direkt në gjykatë dhe për disa të tjera shkohet edhe në bordin e AMA-s është bërë kjo ndarje. Jemi të gjithë të qartë që Këshilli i Ankesave nuk është një organ me personalitete juridike më vete, është brenda AMA-s. Kështu që vendimi, kushdo që e nxjerr, do të jetë vendim kundër AMA-s. Këtë do ta reflektojmë të pika 9, kurse për pikën 7 do të bëjmë një riformulim të teknikës legislative.

Alket Hyseni – Mund të bëjmë një kategorizim sipas kërkesës së medieve lidhur më llojet e vendimmarrjeve? Sa u takon vendimmarrjeve me gjobë apo vendimmarrjeve detyruese për heqje, të hiqet “ankimi nuk pezullon detyrimin e vendimit të Këshillit të Ankesave” dhe sa u takon rasteve të pornografisë, apo që nxisin akte terroriste në pikën 5, kjo të jetë e detyrueshme që ekzekutimi nuk e pengon. Një subjekt mund të gjendet në pamundësi për të paguar gjobën dhe ai nuk shkon dot as në gjykatë.

Vasilika Hysi – Te cila pikë.

Alket Hyseni – Te pika 8. E ndajmë në dy kategori. “Kundër vendimit të AMA-s” do ta rregullojmë. Për pikat 1, 2, 3 dhe 4 ankimi nuk pezullon ekzekutimin, kurse për pikën 5...

Klotilda Bushka – Pra, nuk pezullon për gjobat?

Alket Hyseni – Atij i lejohet të shkojë në gjykatë edhe pa e paguar gjobën, siç është rregulli i përgjithshëm.

Ulsi Manja – Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka - Më fal, se ka nevojë për një saktësim. Në ligjin aktual, neni 131, thuhet që vendimet e AMA-s për gjobë janë titull ekzekutiv, që do të thotë se ekzekutohen menjëherë, pa shkuar pala në gjykatë. Nëse shkon në gjykatë janë të ekzekutueshme. Në qoftë se do të bëjmë këtë ndarje, i bie që nuk do të diskriminohen subjektet e ligjit. Pra, të gjithë atyre që do t’u jepet një vendim me gjobë, qofshin televizione, qofshin radio, qofshin portale, do t’u jepet mundësia të shkojnë në gjykatë dhe të mos u ekzekutohet gjoba. Që kur ka hyrë në fuqi ky ligj kemi një

praktikë, ku gjobat, të cilat vihen ndaj operatorëve audio dhe audiovizivë, paguhen dhe pastaj shkohet në gjykatë. Në qoftë se do ta ndërrojmë këtë praktikë...

Ulsi Manja - ...këtu, duhet ndërruar edhe atje.

Klotilda Bushka – Do ta ndërrojmë si për ata, si për këta. Ky është një diskutim, që, në fakt, në projektligjin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal! Unë po flas për ligjin. Pra, siç parashikon ligji...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, të lutem, ta mbaroj fjalinë! Ta kemi të qartë, pastaj e vendosim, se për këtë jemi këtu. Nuk po marrim vesh se çfarë po themi!

Po themi që sipas arkitekturës së ligjit aktual, për të cilin kemi diskutuar ndryshime, zoti Shamenti, gjobat që vendos AMA për të gjitha subjektet e ligjit, janë tituj ekzekutivë dhe ekzekutohen pavarësisht faktit nëse çështja është apo jo në proces gjyqësor. Kjo që propozoni ju do të thotë që këto gjoba të mos jenë tituj ekzekutivë, por të ekzekutohen në eventualitetin e procesit gjyqësor, kur vendimi të marrë formë të prerë. Kjo hap një diskutim të ri në lidhje me çështjen nëse do t'i përjashtojmë të gjitha subjektet, sepse tashmë nuk kemi vetëm radiot dhe televizionet, që kanë qenë subjekte të ligjit, por kemi edhe portalet. Nuk mund t'i diskriminojmë subjektet. Ky është një diskutim i gjatë. Nuk mendoj se ky komision është i vetmi që mund të vendosë për këtë, por duhet diskutuar me të gjitha komisionet bashkërisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Një sekondë, ju lutem!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Unë diskutimin e kam në parim dhe kushtetues. Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që thotë se cilat janë aktet që ekzekutohen para aksesit në gjykatë. E ka ndarë këtë dhe thotë se ato që kanë të bëjnë me detyrime tatimore e të tjera, janë të detyrueshme, ndërsa ato që kanë të bëjnë me penalitete nuk mund të kushtëzojnë aksesin në gjykatë. Nisur nga ky parim unë pyes: a ka vend për ta diskutuar? Mund të mos ketë, por hajdeni ta diskutojmë edhe këtë!

Ju keni të drejtë, sepse i bie që tani të ndryshojmë edhe strukturën ekzistuese të ligjit, por nuk kemi të njëjtat subjekte. Një televizion, pa e paragjykuar, e ka mundësinë edhe ta parapaguajë gjobën dhe të vazhdojë gjyqin, ndërsa një portal i vogël, i cili nuk nxjerr të ardhura apo nxjerr shumë pak, mund të mos e ketë mundësinë dhe ne gjendemi para faktit të pengimit të aksesit në

gjykatë. Prandaj thashë ta ndajmë në dy grupe. Njëri grup është kategorik dhe detyrimin e tij në rastë terrorizimi apo pornografie, e pranon apo nuk e pranon ai, do ta zbatojë para se të shkojë në gjykatë, detyrimisht, ose të mbyllet, se nuk na dhemb... Ndërkohë, grupin tjetër, që ka të bëjë me gjobën, mund ta shohim. A vlen për diskutim? Le ta kalojmë në parim kështu dhe le ta diskutojmë. Ndoshta nuk e mbyllim këtu.

Ulsi Manja - Po, AMA.

Gentian Sala - Procedura aktuale është e tillë (po e them edhe për mediet, se mbase për juristët...): kryetari i AMA-s, me propozimin e specialistëve, vendos gjobën. I lihet afat subjektiv 30 ditë, të ankohet. Bordi merr vendim në momentin kur çohet për titull ekzekutiv, por sipas Kodit të Procedurës subjekti nuk e pezullon. Kjo të ngelet e njëjtë, sepse tani po themi që nuk e vendos më kryetari, por këshilli i ankesave. Vjen ankesa, të marrë vendim bordi dhe të vazhdojë e njëjta procedurë. Kjo që po bëjmë ne tani, e ndërlikon. Pra, nuk ka nevojë të ndryshohet procedura.

Ulsi Manja – Tani, që të jemi të qartë, nëse një nga qëllimet e këtij projektligji është unifikimi i procedurave si për mediet audiovizive, ashtu edhe për ofruesit e shërbimeve elektronike, sot për sot do të ndjekim këtë standard që ka neni 28 i projektligjit. Dakord? Kështu siç është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sugjerimet e kolegëve, patjetër, mund të diskutohen në një moment të dytë.

Gentian Sala – Gazetarët mbase nuk dinë ta shpjegojnë, por për këtë ankohen.

Ulsi Manja - Zoti Sala, nëse ligji ekzistues i AMA-s e ka titull ekzekutiv për mediet audiovizive, për momentin i njëjti standard do të jetë edhe për ofruesit e shërbimeve elektronike, meqenëse kemi zgjeruar objektin e AMA-s.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si? Do ta rregullojmë, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ta përmbledh nenin 28, se ndoshta është neni më i rëndësishëm i këtij projektligji, që të jemi të qartë se çfarë hedh në votim dhe çfarë do të votoni.

Për nenin 28, që ndryshon nenin 132, ka një ndërhyrje për saktësimin e pikës 1, germa “a”, 2/i. Raporti i vendimmarrjes këshill ankesash-AKEP rregullohet dhe saktësohet, pika 2/i. Te 5/a bëhet një riformulim: “Menjëherë, por jo më vonë se 60 minuta”. Këtu mbyllet pika 5 e nenit 28

për të tria rastet, kur kemi të bëjmë me publikime që kanë të bëjnë me pornografinë me fëmijët, me inkurajimin e akteve terroriste, si dhe me shkelje të sigurisë kombëtare. Ka një saktësim në pikën 6 për shpalljen e vendimit, 7 ditë dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ore, mund ta bëjmë edhe 10 ditë, nuk ka problem. 10 ditë, ndjekim parimet e përgjithshme të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ndryshime të tjera nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thamë atë, e kemi thënë që te...

Vasilika Hysi – Te pika 7 do të ketë një riformulim nga ana e teknikës legjislative...

Ulsi Manja - E kemi thënë që te nenet e para që kemi miratuar. Autoriteti i Medieve e di.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka ndryshime të tjera në nenin 28.

Kush është dakord me nenin 28, me këto...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

E kam thënë. Po flasim për tekst integral, jo për variantin e depozituar në korrik të vitit 2019. Të gjitha ndryshimet i referohen tekstit integral që keni mbi tryezë, të nderuar kolegë. Nuk do ta përsëris më.

Kush është dakord me nenin 28, me këto saktësime? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 29.

Klotilda Bushka – Para se të kalojmë te neni 29, a mund t'ju them diçka, zoti kryetar?

Ulsi Manja – Po.

Klotilda Bushka – Në versionin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave dhe nga nismëtarët ka qenë neni 25, i cili është hequr i gjithë dhe nuk do të jetë më. Ju nuk e keni në draftin integral. Kjo është bërë në konsultim me ekspertët e OSBE-së, sepse përmbajtja e këtij neni është shkrirë dhe është përshtatur në të gjitha nenet e tjera të projektligjit. Kështu që, kalojmë te neni 29.

Ulsi Manja – Jam dakord me sqarimin e koleges Bushka.

Kalojmë te neni 29.

A ka sugjerime për nenin 29?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, bëni një sqarim të shkurtër dhe ta hedhim në votim nenin!

Klotilda Bushka – Neni 29 është ndoshta neni më i debatuar dhe më sensitiv, sepse ka të bëjë me nivelin e gjobave që vendos AMA për shkeljen e këtij ligji.

Dua të sqaroj opinion publik dhe kolegët këtu se niveli i gjobave i parashikuar në këtë nen të ligjit ka të bëjë me nivelin minimal dhe maksimal që aplikohet për raste të caktuara të shkeljeve të këtij ligji. Është AMA autoriteti që bën aktin rregullator për të përcaktuar se sa do të jetë masa e gjobës për një shkelje të caktuar. Pra, është një vendim kuadër.

Ideja është që, në konsultim me ndërkombëtarët, kryesisht me ekspertët e OSBE-së, ne kemi kërkuar të shtohet në pikën 5 të këtij neni një fjali tjetër, e cila shtohet në fund të fjalisë së dytë të pikës 11, ku sipas parashikimeve të nenit 19 të këtij ligji, bazuar në parimin e proporcionalitetit, rëndësia e kësaj shtese ka të bëjë me faktin që jo për të gjitha shkeljet të gjitha subjektet e këtij ligji do të trajtohen njësoj. Pra, AMA në vendimmarrjen e saj për gjobat duhet të marrë në konsideratë disa faktorë, një për të cilëve mund të jetë madhësia e aktivitetit, xhiro e të tjerë. Jo vetëm këto që po ju them, por ka të bëjë, në radhë të parë, rëndësia e shkeljes, pasojat që vijnë e të tjerë. Edhe këto që po ju them kanë të bëjnë me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përsëritja, siç thotë me të drejtë edhe zoti Hyseni.

Këto po i them që ta kuptojë publiku se çfarë nënkuptojmë ne me proporcionalitet, jo se AMA nuk e bën. Na mirëkuptoni! Çdo organ i administratës shtetërore vepron në bazë të parimit të proporcionalitetit kur merr vendime të tilla, por ne sugjerojmë, me të drejtë, ashtu siç kanë kërkuar edhe ekspertët e OSBE-së, të shtohet që në vendimmarrjet për këto çështje AMA të vendosë në kuadër të parimit të proporcionalitetit, e thënë e zezë mbi të bardhë.

Ulsi Manja – Po, zoti Sala.

Gentian Sala - Unë edhe Sara kemi... Duke pasur parasysh eksperiencën, mendoj që gjobat të lihen sa kanë qenë. Pse? Së pari, 40 mijë deri në 400 mijë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka arsye pse të lëvizet, për sa kohë që flitet për medie, që shpejtësinë lajmit e kanë jashtëzakonisht të lartë dhe mundësia për të “gabuar” është shumë e lartë. Gjobat të mos lëvizin,

aq më tepër që në gjykatat administrative 20% e gjobës minimale i bie, pak a shumë, sa maksimumi i gjobës. Kështu që kalon edhe...

Ulsi Manja – Po, zonja Bushka.

Gentian Sala – Më fal!

Kjo që do të thotë Sara është më shumë një gabim...

Ulsi Manja – Po...

Sara Xhumbari – Në pikën 2 germa “b”, sipas propozimit, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje: “Mosrespektimi i vendimit të marrë nga AMA në bazë të dispozitave të parashikuara në nenin 53”. Neni 53 i ligjit aktual është e drejta e përgjigjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, lëreni ta mbarojë, se nuk e mora vesh se çfarë tha!

Sara Xhumbari – Nuk e kam mbaruar akoma.

Vasilika Hysi – Është pika 3 e ligjit...

Ulsi Manja – Zonja Hysi, ta dëgjojmë shqetësimin që ka zonja!

Sara Xhumbari – Në pikën 3, germa “b”, shtohet germa “ë”, për mosrespektimin e nenit 53. Ligji aktual në nenin 133, pika 6, e parashikon këtë sanksion në masën 300 mijë lekë, pra mosrespektimin e nenit 53. Ose duhet hequr pika 6 e ligjit aktual, pra të shfuqizohet, sepse parashikohet një sanksion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...në masën 300 mijë lekë.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 53/1 është më lart.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është vetëm për nenin 53.

Ulsi Manja – Pra, për mosrespektimin e vendimeve të AMA-s në nenin 53 parashikohet gjobë 300 mijë lekë.

Sara Xhumbari – Po, është pika 6 e nenit 133.

Ulsi Manja – Këtu vendosim masë tjetër.

Sara Xhumbari - Ose do të lihet kjo, ose do të hiqet.

(Diskutime pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Do të ngelet vetëm te njëri...

Ulsi Manja – Vetëm te njëri paragraf.

Klotilda Bushka – Ose do të mbetet te germa “ë”, ose te pika 6.

Ulsi Manja – Atëherë, të reflektohet te neni 29, pika 3, germa “ë”. Pra, të hiqet dhe neni të votohet kështu siç është në tekstin integral.

(Diskutime pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 29, me sugjerimin e bërë? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet neni 29.

Neni 30, “Hyrja në fuqi e ligjit”. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, sipas tekstit integral me ndryshimet që u bënë në shqyrtimin dhe miratimin nën për nen në komision. Pro? Kundër? 1 votë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19. 5. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Nikolin Staka dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Elda Hoti, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë:

Evis Fico – Këshilltare e ministrit të Drejtësisë

Irena Malolli – Drejtor në Ministrinë e e Infrastrukturës

Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e e Infrastrukturës

Gentian Sala – Kryetar i AMA-s

Sara Xhumbari – përfaqësuese nga AMA

Jetmir Braha – Drejtor ë AKEP

Marsida Drushku – Përfaqësuese nga drejtoria juridike e AKEP-it

Ulsi Manja – Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19. 5. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””. Këtij projektligji i janë bërë ndryshime shumë të vogla. Grupi që ka punuar me këtë projektligj është dakordësuar dhe ka reflektuar disa sugjerime konkrete. Kërkoj nga relatorja që të vazhdojmë me diskutimin në parim dhe më pas diskutimin nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Diskutimin në parim e bëmë në fillim kur e prezantoi zonja Bushka.

Ka diskutime nga kolegët për këtë projektligj?

Nuk ka.

E hedhim në votim në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet në parim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19. 5. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Zonja Bushka, fillojmë me nenin 1.

Neni 1, sipas tekstit integral që keni mbi tryezë? Pro? Kundër? Nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 2, sipas tekstit integral? Pro? Kundër? Nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 3.

Pro? Kundër? Nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 4.

Jetmir Braha – Ne mendojmë se ka nevojë për t’u bërë një saktësim te ky nen. Për sa i përket pikës 2.1 “nëse ofruesit e shërbimet të komunikimeve publike nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP-it”, duam të sqarojmë se këtu bëhet fjalë për ofruesit e shërbimit të internetit, pasi ato janë objekt të ligjit dhe jo ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike. Duhet ta saktësojmë këtë pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. E thjeshtuar janë ISP-të.

Ulsi Manja – Dakord.

Jetmir Braha – E dyta, ne mendojmë të ruajmë proporcionalitetin e gjobave. Pra, në qoftë se një medie elektronike me ligjin e AMA-s maksimumi gjobitet me 10 milionë lekë të vjetra, e njëjta masë gjobe të jepet edhe për ofruesit e shërbimit internet, pasi referenca në të cilën janë futur, te kreu III, neni 137, është 100 deri në 500 milionë lekë të vjetra për ofruesit e shërbimit internet. Ndërkohë kjo nuk është proporcionale me atë që bën shkelja. Ne mendojmë që kjo duhet të sistemohet në fund të kreut V dhe shtohet si pika 20, ku maksimumi gjoba për ISP-të të jetë 1 milion lekë të reja.

Ulsi Manja – Dakord. Këtë do t’ia bëjmë propozim komisionit përgjegjës të Medies dhe Komisionit të Veprimtarive Prodhuese.

Jemi dakord me nenin 4, me saktësimin që bëri propozim AKEP-i? Kundër? Nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 5.

Hyrja në fuqi e ligjit.

Pro? Kundër? Nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të këtij projektligji.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? 1 votë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19. 5. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””.

Me votimin në tërësi të këtij projektligji, Komisioni i Ligjeve mbyll shqyrtimin dhe miratimin në parim, nen për nen dhe në tërësi të dy projektligjeve të paketës antishpifje.

Dua të falenderoj relatorët e këtij projektligji, zonjën Bushka dhe zonjën Hysi, këshilltarët e komisionit, të gjithë deputetët e përfshirë në diskutimin e këtyre dy projektligjeve, grupin e punës në përbërje të të cilit kanë qenë edhe kolegë të Komisionit të Medias, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, që janë përfshirë në diskutimin e këtyre dy projektligjeve, qoftë në paraqitjen e tyre në dëgjesa publike pranë komisionit, qoftë në prurjen e opinionëve të tyre me shkrim!

Gjithashtu, dua të falenderoj mediet për përfshirjen e tyre në diskutimin e këtyre dy projektligjeve, të gjitha organizatat që u bënë pjesë e diskutimeve të këtyre dy projektligjeve, përfaqësuesit e autoriteteve publike, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Infrastrukturës, AMA-n, AKEP-in, të cilat janë përfshirë intensivisht, qoftë në fazën e draftimit në grupin e punës, qoftë edhe gjatë këtyre ditëve që ne kemi diskutuar këto dy projektligje!

Në fund të fundit janë dy projektligje për të cilët ka pasur debate dhe do të shoqërohen me debate edhe në diskutimin në seancë plenare, sepse kur bëhet fjalë për të gjetur një balancë midis lirisë së fjalës, lirisë së mediave, lirisë së shtypit, lirisë së gazetarëve, por edhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetarëve shqiptarë këto janë çështje shumë sensitive. E rëndësishme është që me këto dy ligje ne kemi rregulluar një procedurë që ka të bëjë me ofruesit e shërbimeve të mediave elektronike. Jetojmë në një kohë dhe shoqëri ku për shkak të zhvillimit të teknologjisë janë të nevojshme edhe këto ndërhyrje.

E theksoj që është një ligj procedural, i cili, në vlerësimin dhe këndvështrimin tim dhe të kolegëve të komisionit që e votuan, nuk e cenon aspak kontentin e lajmit. Thjesht rregullon veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të mediave audiovizive dhe mediave elektronike. Nuk rregullon dhe as nuk prek lirinë e rrjeteve sociale. Sigurisht që në instancë të fundit është gjykata ajo që vendos, qoftë për kontentin e lajmit, qoftë edhe për sanksionet administrative që zbatohen në rastin e shkeljes së këtyre dy ligjeve.

Duke ju kërkuar relatorëve dhe këshilltarëve të komisionit që në raportin që do të bëjmë për komisionin përgjegjës të reflektojnë të gjitha vërejtjet, sugjerimet, por edhe ndryshimet që ne propozojmë për komisionin përgjegjës, t'i zbardhin dhe t'ia dërgojnë komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Këtu përfundojmë me diskutimet për pikat 2 dhe 3 të rendit të ditës.

Shumë faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës, AMA-s dhe AKEP-t!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 11:40

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Nikolin Staka dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Korab Lita, Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Damian Gjiknuri, Elda Hoti, Ediola Braha dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Evis Fico – këshilltare e ministres

Irena Malolli – përfaqësuese nga Ministria e Infrastrukturës

Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës

Gentian Sala – Kryetari i AMA-s

Sara Xhumbari –përfaqësuese e AMA-s

Jetmir Braha – Drejtor i AKEP-it

Marsida Drushku – përfaqësuese e Drejtorisë Juridike në AKEP

Ulsi Manja - Vazhdojmë me pikën e katërt dhe të fundit të rendit të ditës. Është një çështje jo pak e rëndësishme, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, që i propozon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të tërmetit të datës 26 nëntor 2019. Ne jemi komision për dhënie mendimi në shqyrtimin e këtij projektvendimi. Relator do të jetë kolegu Edmond Leka. Ka përfaqësues nga qeveria? Nuk ka.

Zoti Leka, bëni një prezantim të shkurtër për kolegët dhe më pas ta hedhim në votim.

Edmond Leka – Faleminderit, kryetar!

Për shkak të situatës së jashtëzakonshme që u krijua nga tërmeti i datës 26 nëntor, në bazë të Kushtetutës, për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose aksidenti teknologjik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore për të gjithë territorin e vendit ose për një pjesë të territorit të vendit. Meqë ky afat përfundon në datën 28 dhjetor, Këshilli i Ministrave i ka paraqitur Kuvendit një kërkesë për zgjatjen e këtij afati deri në datën 31 mars të vitit 2020. Unë kërkoj që ky propozim i bërë nga Këshilli i Ministrave për Kuvendin e Shqipërisë të merret në Konsideratë dhe të votohet nga të gjithë kolegët e komisionit dhe më pas t’ia kalojmë seancës plenare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

E thashë që në fillim që ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse komision përgjegjës do të jetë Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Diskutimi në këtë komision bëhet nëse projektvendimi i qeverisë është në përputhje me parashikimet kushtetuese. Në fakt, neni 174 i Kushtetutës, pikat 1 dhe 2, i jep të drejtë Këshillit të Ministrave t’i kërkojë Kuvendit dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, që është vendosur me vendimin e Këshillit të Ministrave në datën 28 nëntor. Afati 30 ditor i gjendjes së fatkeqësisë natyrore të vendosur me vendim të Këshillit të Ministrave mbaron në datën 28 dhjetor 2019. Unë e shikoj këtë projektvendim të qeverisë në përputhje të plotë me Kushtetutën, prandaj, pa humbur kohë, i ftoj kolegët ta votojmë projektvendimin e Këshillit të Ministrave, që i kërkon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Kush është dakord që ne ta zgjasim gjendjen e fatkeqësisë natyrore, sipas asaj që kërkon qeveria në projektvendim, deri në datën 31 mars të vitit 2020? Kundër? Nuk ka. Asnjë abstenim.

Miratohet edhe ky projektvendim i Këshillit të Ministrave. Relatori dhe këshilltarja të bëjnë gati raportin dhe t'ia përcjellin Komisionit për Sigurinë Kombëtare, i cili në dijeninë time do ta shqyrtojë po sot këtë projektvendim të qeverisë dhe më pas seancës plenare.

Me ezaurimin e pikës së katërt të rendit të ditës e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Nuk po them që është mbledhja e fundit për këtë vit, sepse ndoshta Komisioni i Ligjeve do të ketë edhe një mbledhje tjetër deri në seancën e datës 18 dhjetor.

Faleminderit për impenjimin dhe diskutimin! Ditë të mbarë dhe javë të mbarë!

Nëse do të kemi mbledhje tjetër, rendi i ditës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

MBYLLET MBLEDHJA